



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT TE KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO
ENVIRONMENTAL
PROTECTION AGENCY



RAPORTI VJETOR I AKTIVITETEVE

2024

Prishtinë, 2024

Hyrje

Gjatë vitit 2024 AMMK ka realizuar aktivitete dhe detyra të përcaktuara sipas objektivave të planit të punës dhe sipas kërkesave ligjore përkatëse.

Aktivitetet dhe veprimet kryesore kanë qenë të fokusuara kryesisht në monitorimin dhe vlerësimin e gjendjes së mjedisit, raportimin mjedisor, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave mjedisore, plotësimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për mjedisin, monitorimin e zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit, menaxhimin e Parqeve Kombëtare, hartimin e planeve rregulluese për zonat e veçanta në kuadër të Parqeve Kombëtare, mirëmbajtjen e rrjetit për monitorimin e cilësisë së ajrit, mirëmbajtjen e rrjetit për monitorimin e sasisë së ujërave sipërfaqësore, implementimin e projekteve, përfaqësimin e AMMK nën nivelin nacional dhe ndërkombëtarë, ngritjen e kapaciteteve etj.

Në këtë Raport janë prezantuar vetëm të arriturat kryesore dhe ngecjeve në realizimin e detyrave të punës të AMMK-së gjatë vitit 2024:

- Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit;
- Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës;
- Instituti për Mbrojtjen e Natyrës të Kosovës;
- Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtarë “Sharri”;
- Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”;
- Drejtoria për Administrimin e Monumenteve të Natyrës me Rëndësi të Veçantë

Buxheti i shtetit i ndarë për AMMK-në në vitin 2024:

Buxheti i përgjithshëm i AMMK - 2024	Vlera në Euro
1. Paga dhe mëditje	602.955.00
2. Shpenzime komunale	73,870.00
3. Shpenzime kapitale (projekte)	590.000.00
4. Mallra dhe shërbime	1,000,001.00
Totali	1,073,871.00

Shpenzimet kapitale – projektet e financuara nga buxheti i shtetit:

1. Furnizimi me pajisje (senzore) për mirëmbajtje të stacioneve automatike të rrjetit meteorologjik dhe automatizimin e tij, përfshirë pajisjet meteorologjike për Shpellën e Gadimes;
2. Furnizimi me material laboratorik të laboratorit të IHMK;
3. Furnizimi me vetura terreni për nevojat e DAPK Sharri;
4. Furnizimi me kontenjer dhe shporta të mbeturinave për zonat turistike të Parqeve Kombëtare;
5. Furnizimi me kompjuter, makina fotokopjuese, dhe pajisje tjera të teknologjisë informative;
6. Shërbime shtypje jomarketing: Shtypja e biletave për nevojat e MNRV Shpella e Gadimës, shtypja e materialit tjetër zyrtarë për nevojat e AMMK dhe të drejtorive në kuadër të AMMK, si protokole, fletëparaqitje, fletëurdheres;
7. Riparimi dhe servisimi i pajisjeve të laboratorit të IHMK;
8. Sigurimi fizik i objektit të IHMK dhe objekteve të DAPK Bjeshkët e Nemuna;
9. Mirëmbajtja e pastërtisë në zonen turistike të Prevallës;
10. Mirëmbajtja e objekteve të IHMK me të gjitha objektet, DAPK Sharri, DAPK Bjeshkët e Nemuna dhe MNRV Shpella e Gadimës;
11. Mirëmbajtja dhe servisimi i pajisjeve të rrjetit hidrometrik të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësor;
12. Angazhimi i eksperteve për ofrimin e shërbimeve për nevojat e AMMK;
13. Shërbimet dhe furnizimet për AMMK për vlerat minimale;
14. Përditesimi i regjistrit (kadastrit) të mbeturinave të rrezikshme dhe kemikateve dhe trajnimi i operatorëve për plotësimin e të dhënave;
15. Caktimi i një lokacioni me qira për vendosjen e masës drusore dhe pajisjeve të sekuestruara nga aktivitetet ilegal;
16. Shërbimi për qiran e objektit të PK Bjeshkët e Nemuna;
17. Mirëmbajtja dhe përditesimi i web aplikacioneve për mbeturina;
18. Prishja, mbyllja e rrugëve alternative në territorin e PK Sharri;
19. Shenjëzimi dhe digjitalizimi i zonave të mbrojtura të natyres;
20. Ndërtimi i objektit të IHMK në parcelën ekzistuese të IHMK;
21. Ndërtimi dhe Digjitalizimi i Sistemit për Monitorimin e PK Sharr (mjetet do të përdoren për projektin me Global Conservation ose ndërtimi i Qendres së Informimit)- DAPK "Sharri";
22. Ndërtimi i objektit (Zyreve) në Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna;
23. Rregullimi i ambienteve në vendndodhjen e objektit të IHMK (rrenimi i objektit të ish restaurant Pellumbi, vendosja e rrethojave, rregullimi i oborrit në kubëza betoni dhe asfalt);
24. Renovimi i Objekteve të AMMK-së (Objektet e Stacioneve Meteorologjike të IHMK); Rregullimi i sistemit të energjisë elektrike në DAPK "Sharri".

Projektet e financuara nga donatorët gjatë vitit 2024:

- Faza e dytë e projektit për ngritjen e kapaciteteve institucionale për kontrollin e ndotjes së ajrit, i financuar nga Agjencia Japoneze për bashkëpunim ndërkombëtarë (JICA);
- Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave me fokus riciklimin, i financuar nga Agjencia Japoneze për bashkëpunim ndërkombëtarë (JICA);
- Projekti për menaxhimin e integruar të resurseve ujore në Kosovë, i financuar nga Qeveria Zvicerane dhe implementuar nga SKAT Consulting;
- Projekti i bashkëpunimit në mes të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Suedisë i financuar nga SIDA Suedeze;
- Projekti për zhvillimin e Regjistrimit të shkarkimeve në mjedis (PRTR) i financuar nga Qeveria e Gjermanisë; dhe
- Zhvillimi i aplikacionit për raportim për mbeturina i financuar nga GIZ.

1. Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit

1.1. Raportimi, informimi dhe komunikimi me publikut

Në kuadër të aktiviteteve dhe angazhimeve në procesin e Raportimit për gjendjen e mjedisit dhe raportimit për gjendjen e sektorëve të veçantë mjedisor, DVGJM ka:

- Përgatitur Raportin vjetor për gjendjen e mjedisit 2023, i cili është proceduar në Qeveri të Republikës së Kosovës;
- Publikuar Raportin vjetor për gjendjen e mjedisit 2022 në kopje fizike dhe elektronike në tri versione gjuhë shqipe, angleze dhe serbe;
- Përgatitur Raporti vjetor i përgjithshëm për gjendjen e ajrit në Kosovës për vitin 2023 i cili është publikuar në formatin elektronik në web faqen e AMMK;
- [Vjetari Hidrometeorologjik 2022 - https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Vjetari_2022-AL.pdf](https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Vjetari_2022-AL.pdf)
- Vjetari Hidrometeorologjik 2023
- Është përgatitur Raporti vjetor për gjendjen e mbeturinave në Kosovë për vitin 2022 i cili është publikuar në formatin elektronik i raportit në web faqen e AMMK;
- Raport 9 mujor për nivelin e zbatimit të Planit Vjetor të Përformancës së Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës për vitin 2024;
- Raportimi javor;
- Raportim mbi zbatimin e Planit Kombëtar për Zhvillim (PKZH) 2024-2026;
- Raportimi për Inputin e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për Kosovën;
- Raport për zbatimin e konkluzioneve nga Nën-komitetit INFRA;
- Raportimi për zbatimin e Planit të Integritetit të AMMK;
- Është hartuar dhe dorëzuar Raporti vjetor për Agjencinë për Informim dhe Privatësi në janar 2024 për vitin 2023;
- Është hartuar dhe dorëzuar Raporti vjetor i Sinjalizimit për Agjencinë Kundër Korrupsionit në janar 2024 për vitin 2023;
- Është hartuar dhe dorëzuar Raporti vjetor i Konfliktit të Interesit për Agjencinë Kundër Korrupsionit në janar 2024 për vitin 2023;
- Raportimi për aktivitetet e AMMK në kuadër të Planit për zbatimin e Strategjisë së Energjisë;
- Raportimi i aktiviteteve të AMMK në kuadër të Monitorimit të zbatimit të Planit të veprimt .Programi për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore (2021-2025), dhe Plani i Veprimt (2021-2023); dhe
- Raportimi për qasje në dokumente publike.

AMMK, në kuadër të përmbushjes së obligimeve për informimin e publikut, në vazhdimësi ka informuar mediat për aktivitetet e saj dhe për gjendjen e mjedisit përmes njoftimeve për media si dhe përmes informatave të publikuara në web faqe dhe profilin në facebook.

1. Disa rregulla themelore të mbrojtjes nga rrufeja;
2. Shqyrtim publik i Planeve për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore Ibër, Lepenc dhe Morava e Binçës;
3. Trajnimi rojtarëve të natyrës të parqeve kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna"
4. Diskutohet Drafti i Planit Menaxhues për Parkut Kombëtar "Sharri";
5. Paralajmërim për ndërmarrjen e masave për aktivitetet ilegale me mjete motorike në Parqe Kombëtare;
6. VSM si instrument për pasurimin e Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar Sharri
7. Akreditohet laborator i cilësisë së ujit i IHMK;
8. AMMK takohet me përfaqësuesit e Federatës së Motoçiklizmit të Kosovës;
9. Rrjedhat e të dhënave bazë të EIONET për vitin 2023- Kosova përmbush 100% të obligimeve;
10. Diskutohen mundësitë e bashkëpunimit në mes të AMMK dhe EPA-s amerikane
11. Mbahet trajnimi katër ditor për Vlerësimin Strategjik Mjedisor;
12. Zyrtaret e AMMK përfitojnë përvoja për hulumtime të avancuara kërkimore në Universitetin e Milanos;
13. Kosova prezanton përvojat e saj të bashkëpunimit ndër-institucional për menaxhimin e zjarreve pyjore para anëtarëve të rrjetit evropian EIONET;
14. AMMK mirëpriti në takim përfaqësuesit e konsorciumit të projektit ISLANDR;
15. UNICEF lansoi raportin "Analizë mbi Gjendjen Klimatike për Fëmijët në Kosovë";
1. Fillon shërbimi për për menaxhimin mbeturinave dhe mirëmbajtjen e zonës së Rugovës të PK "Bjeshkët e Nemuna"
2. "Monumentet natyrore - trungjet e vjetra", pjesë e emisionit të ri të pullave postare
3. Raporti për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë, 2022
4. Guidelines for CSOs on the use of information in PRTR (alb)
5. Rehabilitohet lejkë i lënduar dhe kthehet në çerdhën e tij!
6. Thirrje për mbrojtje të pyjeve të Parqe Kombëtare nga zjarret
7. Fuqizohet mbikëqyrja e Parqeve Kombëtare
8. Publikohet Raporti vjetor për gjendjen e ajrit në Kosovë për vitin 2023
9. Vihet nën mbrojtje paraprake "Guri i Hoxhës në Grykën e Lumit të Perlepnicës"
10. Vendosen platforma për fole të zogjve folenizues!
11. 20 pjesëmarrës nga Kosova certifikohen nga Akademia e Mjedisit të BE
12. Miratohet Plani Menaxhues për Parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna"
13. 13 zona të reja të trashëgimisë natyrore i shtohen regjistrit të zonave të mbrojtura të Kosovës
14. Kompletohet Rrjeti Hidrometrik i Monitorimit dhe Raportimit në Kohë Reale
15. Kosova anëtarësohet në Rrjetin Evropian të Agjencive për Mbrojtjen e Natyrës –ENCA
16. Studimi "Ndotja e ajrit në Kosovë - Masat dhe instrumentet"!
17. Vendosen tabela informuese në Monumentin e Natyrës Ujëvarat e Mirushës
18. Ajër i pastër = SHËNDET
19. [Udhëzues për OSHC-të për përdorimin e RSHTN](#)
20. Vjetari Hidrometeorologjik 2022
21. Vjetari Hidrometeorologjik 2021
22. Raporti për gjendjen e ajrit 2023
23. Raporti për gjendjen e Mjedisit 2022
24. Definimi i vitit bazë për GHG

25. Ndotja e ajrit në Kosovë, Masat dhe Instrumentet
 26. Informata lidhur me Zyrtarin përgjegjes për sinjalizim
 27. Konsultimi Publik i Propozimit Profesional për Ri Kategorizimin e Monumentit të Natyrës Kanioni i Drinit të Bardhë të Ura e Fshejtë
 28. [Plani Hapësinor për PK "Bjeshkët e Nemuna"](#)
 29. [Rishikimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023-2027 dhe Plani i Veprimit 2023-2025](#)
-

Facebook

1. *Avancimi dhe automatizimi i rrjetit të monitorimit hidro-meteorologjik të Kosovës.*
2. *Studentët e Ekologjisë nga FSHMN vizitojnë Institutin për Mbrojtjen e Natyrës.*
3. *Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëorganizim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Komunën e Prishtinës, OJQ-të: INDEP, ESRA, ECOPANA/WWF Adria, "Marakli t'Biciklave" kanë filluar shënimin e 8 Nëntorit "Ditës Ndërkombëtare të Zonave Urbane" me aktivitete ne SHFMU "Gjergj Fishta". Vazhdojmë sipas agjendes...*
4. *Po vazhdojnë përpjekjet për menaxhimin e vatrave të zjarrit në territorin e PK "Bjeshkët e Nemuna".*
5. *Shkëmbehen përvojat rajonale për menaxhimin e pyjeve në zonën ndërkufitare të Maleve të Sharrit dhe Masivit të Korabit*
6. *DAPK "Sharri" pjesë e konferencës rajonale "Menaxhimi i Integruar i Pyjeve përgjatë basenit të lumit Drin".*
7. *UNICEF lansoi raportin "Analizë mbi Gjendjen Klimatike për Fëmijët në Kosovë".*
8. *Gjenerimi i Mbeturinave Komunale (MK) sipas Regjionave dhe në nivel Nacional, për 2021 & 2022*
9. *AMMK mirëpriti në takim përfaqësuesit e konsorciumit të projektit ISLANDR*
10. *Kosova prezanton përvojat e saj të bashkëpunimit ndër-institucional për menaxhimin e zjarreve pyjore para anëtarëve të rrjetit evropian EIONET.*
11. *Mbahet trajnimi katër ditor për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)*
12. *Zyrtaret e AMMK përfitojnë përvoja për hulumtime të avancuara kërkimore në Universitetin e Milanos*
13. *Pajtueshmëria me kornizën ligjore dhe planifikuese për menaxhim të Mbeturinave Komunale 2021 & 2022, sipas regjioneve.*
14. *Diskutohen mundësitë e bashkëpunimit në mes të AMMK dhe EPA-s amerikan*
15. *Rrjedhat e të dhënave bazë të EIONET për vitin 2023- Kosova përmbush 100% të obligimeve për raportim*
16. *4 Tetori - Dita Botërore për Mbrojtjen e Kafshëve*
17. *Lajm i shkëlqyeshëm për cilësinë e ujit në Kosovë!*
18. *Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) ka arritur një moment historik duke u akredituar laboratorin e tij të cilësisë së ujit në SK EN ISO/IEC 17025:2018*

19. *Në Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës janë mirëpritur në takim Znj. Rea Gashi nga Instituti Kombëtar Demokratik se bashku me pjesëmarrës të programit "Akademia e të Rinjëve për Integritet".*

20. Vlerësimi Strategjik Mjedisor si instrument për pasurimin e Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar Sharri
21. Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Dr.Afrim Berisha, ka pritur sot në takim Drejtoreshën e Korpusit Amerikan të Paqes në Kosovë Dr.Carolyne Siganda
22. Vizitoni uebfaqen e projektit EU4Green.
23. U mbajt takimi i parë konsultativ për hartimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për draft-planin hapësinor të Parkut Kombëtar Sharri.
24. Njoftim me rëndësi nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
25. Sipas disa parashikimeve, nga fundjava, sidomos me datë 04 dhe 05 tetor 2024, rajoni dhe jo vetëm do të përfshihen nga reshjet të shumta të shiut, si pasojë edhe përmbytje të mundëshme nëpër disa vende.
26. Punëtorja dhe trajnimi në terren me rojtarët e natyrës së parqeve kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna" organizuar në bashkëpunim nga KEERC, AMMK dhe Universiteti i Konstanzes
27. Aktivitetet me mjete motorike në Parqe Kombëtare janë të ndaluara! **Video**
28. Paralajmërim për ndërmarrjen e masave për aktivitetet ilegale me mjete motorike në territorin e Parkut Kombëtar "Sharri"
29. Diskutohet Drafti i Plani Menaxhues për Parkut Kombëtar "Sharri".
30. Ka filluar implemtimi i projektit për **pastrimin e shtretërve të Lumenjëve të Kosovës**
31. Disa rregulla themelore të mbrojtjes nga rrufeja të rekomanduara nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
32. Gjendja në PK Sharri, sot duket më e qetë nga zjarret pyjore!
33. Kujdes nga temperaturat e larta!
34. Edhe sot kanë vazhduar angazhimet për menaxhimin e vatrave të zjarrit në Parkun Kombëtarë "Sharri"!
35. Fillon shërbimi për menaxhimin e mbeturinave dhe mirëmbajtjen e zonës së Rugovës të PK "Bjeshkët e Nemuna".
36. "Monumentet natyrore - trugjet e vjetra", në pulla postare
37. Vazhdojnë të jenë aktive disa vatra të zjarreve pyjore në Parkun Kombëtarë "Sharri"!
38. Vazhdon monitorimi i zjarreve në zonën e Oshlakut dhe Prevallës!
39. Pas reshjeve të shiut mbrëmë, sot gjendja me zjarre në pyjet e rrobullit në rezervatin strikt të natyrës në malin Oshlak dhe në zonën e gjerë të Prevallës është nën kontrollë dhe nuk paraqet ndonjë rrezik për përhapje masive.
40. Raporti për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë, 2022
41. Gjendje e rënduar nga zjarret në pyjet e rrobullit në OSHLAK të PK Sharri.
42. Drejtorja e Parkut Kombëtarë "Sharri" bënë thirrje për ndihmë në shuarjen e zjarrit!
43. Lidhet marrëveshje për menaxhimin mbeturinave dhe mirëmbajtjen e zonës së Rugovës të PK "Bjeshkët e Nemuna"
44. Udhëzues për OSHC-të për përdorimin e informacionit në RSHTN
45. Në këto ditë të nxehta me temperatura të larta, ne duhet të jemi vigjilentë në përpjekjet tona për të mbrojtur resurset natyrore nga ndikimi shkatërrues i zjarreve.
46. Rehabilitohet lejleku i lënduar dhe kthehet në çerdhen e tij!
47. Në këto ditë të nxehta me temperatura të larta ne duhet të jemi vigjilentë në përpjekjet tona për të mbrojtur Parqet Kombëtare nga ndikimi shkatërrues i zjarreve

48. Thirrje për mbrojtje të pyjeve të Parqeve Kombëtare nga zjarret
49. Fuqizohet mbikëqyrja e Parqeve Kombëtare
50. Ajër i Pastër = Shëndet / video
51. Publikohet Raporti vjetor për gjendjen e ajrit në Kosovë për vitin 2023
52. Parqet Kombëtare të Kosovës, pasuri e rrallë natyrore! / video
53. Fuqizohet rrjeti për mbledhjen e të dhënave të reshjeve
54. Ka ndërruar jetë profesori Sylë Tahirsylaj, ish drejtori i Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës
55. Shpallen fituesit e Çmimit Mjedisor për Shkolla “Dervish Rozhaja” 2024, lansuar në kuadër të projektit “Ndikimi i Rinisë në Mjedis” (YENI)!
56. Statusi i Cilësisë së Ajrit në Evropë 2024
57. 5 Qershori - Dita Ndërkombëtare e Mjedisit përmes videos Toka jonë, e ardhmja jonë.
58. Projekti për zhvillimin e kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit në Republikën e Kosovës, mbështetur nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtarë (**JICA**), një kontribut i vlefshëm për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e cilësisë së ajrit, dhe për vlerësimin e masave për reduktimin e ndotjes. / video
59. 5 Qershori - Dita Ndërkombëtare e Mjedisit përmes fotove
60. 5 Qershori - Dita Ndërkombëtare e Mjedisit
61. 24 Maji - Dita e Parqeve Kombëtare në “Bjeshkët e Nemuna”
62. 24 Maji - Dita e Parqeve Kombëtare
63. Ftesë për Ditën e Parqeve Evropiane në Parkun Kombëtar "Sharri"/AMMK-MMPHI / video
64. 22 Maj - Dita e Biodiversitetit
65. Kosova dhe Suedia Bashkëpunojnë për ujë të pastër
66. Rrjedha e Lumit Lepenc
67. Parqet Kombëtare të Kosovës po përballen me sfida të mëdha.
68. Vihet nën mbrojtje paraprake “Guri i Hoxhës në Grykën e Lumit të Perlepnices”
69. Kosova është e bekuar me pasuritë natyrore, disa nga të cilat janë të shpallura si zona të mbrojtura. Numri i përgjithshëm i zonave të mbrojtura të natyrës në Kosovë është 273 zona, duke përfaqësuar 11.7% të sipërfaqes së Kosovës
70. 24 Maj - Dita Evropiane e Parqeve
71. Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”/AMMK-MMPHI planifikon shënimin e Ditës së Parqeve Evropiane.
72. Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”/AMMK-MMPHI planifikon shënimin e Ditës së Parqeve Evropiane.
73. Disa pamje nga bukuritë e Ujëvarës së Mirushës, Monument i Mbrojtur i Natyrës me Rëndësi të Veçantë! / video
74. AMMK, derë e hapur për kryerjen e praktikës dhe realizimin e hulumtimeve për studentët e shkencave të mjedisit
75. Vendosen platforma për fole të zogjve folenizues!
76. Sipas raportit më të ri të Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor që fokusohet në Gjelbërimin e Qyteteve, nxehtësia ekstreme në qytetet e Ballkanit Perëndimor është përkeqësuar ndjeshëm
77. Dita Botërore e Tokës! / video
78. Pjesë nga aktivitetet e organizuara nga MMPHI me rastin e shënimit të 22 Prillit, Ditës Botërore të Tokës.

79. Studentë vullnetarë, organizata vendore dhe ndërkombëtare mbollën drurë në prag të shënimit të 22 Prillit "Ditës Botërore të Tokës". / video
80. 20 pjesëmarrës nga Kosova certifikohen nga Akademia e Mjedisit të BE
81. Edicioni i dytë i Çmimit Mjedisor për Shkollë "Dervish Rozhaja"!
82. Vlerësimi i aspekteve socio-ekonomike të Parkut Kombëtarë "Sharri"
83. Miratohen Plani Menaxhues për Parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna"
84. Posta e Kosovës, promovon llojet e faunës endemike të Kosovës
85. Sqarim!
86. Akademia e Mjedisit të BE 2024 – Thirrje për aplikim!
87. 23 Marsi, Dita Botërore e Meteorologjisë!
88. 22 Mars Dita Botërore e Ujit dhe 23 Mars Dita Botërore e Meteorologjisë / video
89. 22 Marsi "Dita Ndërkombëtare e Ujërave" & 23 Marsi "Dita Botërore e Meteorologjisë"
90. Gëzuar Dita e Pranverës!
91. Inspektorati i Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit gjatë vitit 2023 sa i përket edhe mbrojtjes së cilësisë së ajrit
92. Lufta në ajër e Cërlojave pikalosh (Sturnus vullgaris)
93. "Vallëzimi elegant i hutave"!
94. 13 zona të reja të trashëgimisë natyrore i shtohen regjistrit të zonave të mbrojtura të Kosovës
95. Inspektorati i Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit bazuar në autorizimet dhe përgjegjësitë në Ligjin Nr. 04/L-175, gjatë vitit 2023 ka realizuar 1,204 aktivitete
96. Dokumentohen prania edhe e 9 llojeve të shpendëve të egra në Kosovë
97. Kanioni i Lumit Mirusha!
98. Vazhdimësi e subvencionimit, Ministria e Ekonomisë ka të hapura Thirrje publike për mbështetjen konsumatorëve familjar dhe ndërmarrjeve mikro të vogla dhe të mesme, në investimin në sisteme të energjisë së ripërtëritshme
99. Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK), ka finalizuar njërin nga projektet më të rëndësishme në fushën e hidrologjisë në Kosovë. Ky projekt përmes së cilit është ngritur rrjeti i raportimit hidrometrik në kohë reale, është financuar nga Banka Botërore përmes programit FLOWS.
100. Kosova anëtarësohet në Rrjetin Evropian të Agjencive për Mbrojtjen e Natyrës – ENCA.
101. Gjatë vitit 2022, Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Ministrisë së Ekonomisë ka ndarë buxhet në shumë prej 6 milion euro, për të subvencionuar pajisjet ngrohëse.
102. Portali i Cilësisë së Ajrit Kosova (PCA) është shërbim publik që ofron informacion aktual të statistikave vjetore nga rrjeti i 12 stacioneve të monitorimit.
103. Portali i Cilësisë së Ajrit Kosova (PCA) është shërbim publik që ofron informacion aktual të cilësisë së ajrit nga rrjeti i 12 stacioneve të monitorimit. Gjithashtu ofron parashikim 3-ditor të cilësisë së parashikuar të ajrit në bazë të modelimit matematikor.
104. Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës –Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) përmes Projektit "Përmirësimi i të dhënave mjedisore në Kosovë" të financiar nga SIDA suedeze, ka sponsorizuar videon e stripit "Erërat e Gjelbërta të Ndyshimit" të bashkëautorët Ana Krasniqi dhe Edvin Susuri.

105. Bashkëpunim i Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës – MMPHI me Ambasadën e Suedisë në Kosovë për promovimin e videos dhe stripit "Erërat e Gjelbërta të Ndyshimit".
106. Monitorimi i cilësisë së ajrit është vlerësim sistematik dhe afatgjatë i niveleve të ndotësve, duke matur cilësinë e ajrit në një rrethinë të caktuar.
107. Drejtori i DAPK Sharri takon përfaqësuesit e EURONATUR dhe CNVP.
108. Dallimi i grimcave dhe ndotësve.
109. Si ndikon PM 2.5 në shëndetin e njeriut
110. PM 2.5 janë grimca shumë të vogla me madhësi prej 2,5 mikrometra (0,0025 milimetra).
111. Si ndikon PM 10 në shëndetin e njeriut.
112. Vendosen tabela informuese në Monumentin e Natyrës Ujëvara e Mirushës.
113. PM 10 është grimce e ngurtë me madhësi prej 10 mikrometra (0.01 milimetër) të cilat vijnë kryesisht nga burimet natyrore dhe proceset industrial.
114. 2 Shkurti, Dita Botërore e Ligatinave.
115. Si ndikon NO₂ në shëndetin e njeriut?
116. Gjatë procesit të djegies në temperatura të larta, oksidet e azotit reagojnë me oksigjenin dhe oksidohen duke formuar Dioksidin e Azotit (NO₂).
117. Imagjinoni një botë ku çdo frymëmarrje është dhuratë, dhe ku në çdo hap jashtë është një shans për t'u rrethuar nga bukuria e natyrës. Ne mund ta krijojmë këtë botë, por ajo fillon me ne./ video.
118. Si ndikon CO në shëndetin e njeriut.
119. Monoksidi i Karbonit (CO) lirohet në atmosferë kur digjen karburantet dhe materialet me bazë karboni.
120. Si ndikon O₃ në shëndetin e njeriut.
121. Ozoni (O₃) formohet në atmosferë kur automjetet dhe fabrikat lirojnë ndotës të cilët më pastaj reagojnë në ndikimin e dritës së diellit, por mund të formohet edhe në mënyra natyrore.
122. Si ndikon SO₂ në shëndetin e njeriut.
123. Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) në bashkëpunim me Agjencinë Suedeze për Mbrojtjen e Mjedisit (SEPA) dhe Ambasadën Suedeze në Kosovë, kanë nisur fushatën "Ajër i pastër = SHËNDET".
124. Dyoksidi i Squfurit (SO₂) formohet kur digjen karburantet që përmbajnë squfur.

Shyrtimi, përgjigjet për të dhëna, dhe realizimi i intervistave me media elektronike dhe të shkruara.

Në lidhje me shënimin e ngjarjeve mjedisore, është marrë pjesë në Këshilla organizativ dhe grupe punuese për aktivitete përkatëse.

Studime:

Studimi Ndotja e Ajrit në Kosovë-Masat dhe Instrumentet
rks.net/assets/cms/uploads/files/Raport%20-%20Ndotja%20e%20ajrit%20n%C3%AB%20Kosov%C3%AB.pdf

1.2. Monitorimi dhe Vlerësimi i Gjendjes së Mjedisit

1.2.1. Vlerësimi i gjendjes së ajrit

- Është bërë vlerësimi dhe arkivimi i të dhënave për cilësinë e ajrit nga stacionet monitoruese për cilësi të ajrit për vitin 2023;
- Është përgatitur Raporti vjetor i përgjithshëm për gjëndjen e ajrit në Kosovë, për vitin 2023;
- Është bërë vlerësimi i emisioneve (raporte të pranuar nga operatorët; KEK, Feronikel, Sharrcem, dhe operatoreve tjerë);
- Janë përpunuar të dhënat për cilësinë e ajrit, emisionet dhe janë prezantuar në formë të raporteve në baza mujore, tre mujore, gjashtë mujore, vjetore dhe sipas kërkesave të MMPHI.

1.2.1. Vlerësimi i gjendjes së deponive sanitare, deponive ilegale dhe impianteve për sterilizim

- Janë pranuar, vlerësuar dhe analizuar raportet për mbeturinat nga Komunitat, operatorët, kompanit publike dhe operatorët e licencuar për menaxhim të mbeturinave, për vitin 2022;
- Është bërë monitorimi në terren i disa prej deponive sanitare dhe i impianteve për sterilizimin e mbeturinave mjekësore;
- Është bërë regjistrimi i deponive ilegale për vitin 2024;

1.2.2. Vlerësimi i gjendjes së ujërave

- Është bërë vlerësimi i të dhënave për gjëndjen e ujërave sipërfaqësor në vend për vitin 2023 (IHMK).
- Është përgatitur Raporti vjetor i përgjithshëm për gjëndjen e ujërave në Kosovës, për vitin 2023.
- Janë analizuar raportet e pranuar nga KEK, Feronikeli dhe SharrCem, dhe operatorëve tjerë për shkarkimet e ujërave dhe ujërave nëntokësor për vitin 2023.
- Janë vlerësuar të dhënat për trajtimin e ujërave nga impianti për trajtim të ujërave në Skënderaj.
- Janë analizuar raportet për gjëndjen e ndikimit në shëndet nga IKSHP, sëmundjet ambientale për vitin 2023.

1.2.3. Vlerësimi për ndotjen akustike dhe shëndet

- Janë siguruar të dhënat nga IKSHPK në lidhje me sëmundjet ambientale për vitin 2023;
- Janë pranuar dhe vlerësuar të dhënat nga ARRU dhe IKSHPK, për cilësinë e ujit të pijes, për vitin 2023;
- Janë siguruar dhe vlerësuar të dhënat për mbeturinat spitalore 2023;
- Nuk ka të dhëna për ndotjen akustike, por njëherit nuk ka as sistem të monitorimit.

1.3. Raportimi, informimi dhe komunikimi me publikun

Për vitin 2024 në lidhje me raportimin, informimin dhe komunikimin me publikun ka realizuar një mori aktivitete:

1.3.1. Përgaditja e raporteve sektoriale për vitin 2023 (ajri, uji, mbeturinat, tokën, sëmundjet ambientale), si dhe raporte tjera të kërkuara nga MMPHI dhe publiku,

1.3.2. Përgaditja e raportit për Gjendjen e Mjedisit për vitin 2023,

1.3.3. Kërkesave të pranuar nga MMPH, institucionet tjera, donator, OJQ, studentë dhe publiku, në lidhje me indikatorët mjedisor janë realizuar në formë të përgjigjes,

1.3.4. Në kuadër të senzibilizimit të publikut për mbrotjen e mjedisit, stafi ka marrë pjesë në shumë evenimente të veçanta siç janë ditët ndërkombetare të tokës, ujërave, mjedisit, ecja në këmbë etj.

1.4. Bashkëpunimi me Agjencionin Evropian të Mjedisit dhe Raportimi në EIONET, pjesëmarrja në punën e EPA Network

Stafi i Sektorit Për Vlerësim të Gjendjes së Mjedisit gjatë vitit 2024, i është përgjigjur kërkesave të vazhdueshëm të EEA dhe Raportimit në Rrjetin Evropian të Sistemit të Informimit dhe Mbikëqyerjes - EIONET. Në procesin e takimeve dhe raportimeve Stafi i Sektorit të Monitorimit ka realizuar këto aktivitete: Sipas kërkesave të EEA-EIONET, Stafi i SVGJM i është përgjigjur në forma të ndryshme, qoftë me pjesëmarrje në takime, plotësimin e factsheet-eve, raportimeve obligative sipas NRC ë përcaktuar për sektor të ndryshëm, si dhe ofrimin e të dhënave që posedojmë.

Raportimet janë realizuar përmes një pune kolosale dhe përkushtimi maksimal ku janë raportuar:

- WISE 1 SoR Emetimet në ujëra
- WISE 3 SoR Sasia e ujërave
- WISE 5 SoR Të dhënat hapësinore
- WISE 6 SoR Cilësia e ujërave
- Zonat e përcaktuara në nivel kombëtar (CDDA)

- Raportimi për Emisionet ne ajër (CLRTAP)
- Raportimi për Inventarin e Gazrave Serrë
- Raportimi për LCP Direktivën (2001/80)
- (E1a) Të dhëna të vërtetuara të vlerësimit parësor – informacion mbi matjet
- (D1b) Informacion mbi metodat e vlerësimit (nenet 8 dhe 9) - për modelet dhe vlerësimin objektiv

Gjatë vitit 2022, 2023 dhe 2024, sipas vlerësimit të bërë këtë vit nga Agjencia e Mjedisit të Evropës lidhur për Rrjedhën e të dhënave, Kosova ka plotësuar 100% të obligimeve për raportim.

1.5. Janë hartuar këto Plane dhe programe

- Hartimi i Planit të integritetit sipas kërkesave të AKK;
- Hartimi i Planit për Përformancën e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës për vitin 2025;
- Është në proces hartimi i Raportit për Përformancën e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës për vitin 2025;
- Është hartuar Plani i punë së AMMK për vitin 2025;
- Është në proces hartimi i Planit paraprak të prokurimit të AMMK për vitin 2025;
- Është në proces hartimi i Planit paraprak i buxhetit të AMMK për vitin 2025; dhe
- Është në proces hartimi i Planit të rekrutimit të personelit të AMMK për vitin 2025.

1.7. Koordinimi dhe zbatimi i Projekteve

Janë koordinuar dhe finalizuar projektet kapitale të financuar nga buxheti i Republikës së Kosovës:

25. Furnizimi me pajisje (senzore) për mirëmbajtje të stacioneve automatike të rrjetit meteorologjik dhe automatizimi i tij, përfshirë pajisjet meteorologjike për Shpellën e Gadimes;
26. Furnizimi me material laboratorik të laboratorit të IHMK;
27. Furnizimi me vetura terreni për nevojat e DAPK Sharri;
28. Furnizimi me kontenjer dhe shporta të mbeturinave për zonat turistike të Parqeve Kombetare;
29. Furnizimi me kompjuter, makina fotokopjuese, dhe pajisje tjera të teknologjisë informative;
30. Sherbime shtypje jomarketing: Shtypja e biletave për nevojat e MNRV Shpella e Gadimës, shtypja e materialit tjetër zyrtarë për nevojat e AMMK dhe të drejtorive në kuadër të AMMK, si protokole, fletëparaqitje, fletëurdheres;
31. Riparimi dhe servisimi i pajisjeve të laboratorit të IHMK;

32. Sigurimi fizik i objektit të IHMK dhe objektivave të DAPK Bjeshkët e Nemuna;
33. Mirëmbajtja e pastërtisë në zonen turistike të Prevallës;
34. Mirëmbajtja e objekteve të IHMK me të gjitha objektet, DAPK Sharri, DAPK Bjeshket e Nemuna dhe MNRV Shpella e Gadimes;
35. Mirëmbajtja dhe servisimi i pajisjeve të rrjetit hidrometrik të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësor;
36. Angazhimi i eksperteve për ofrimin e shërbimeve për nevojat e AMMK;
37. Shërbimet dhe furnizimet për AMMK për vlerat minimale;
38. Përditësimi i regjistrit (kadastrit) të mbeturinave të rrezikshme dhe kemikateve dhe trajnimi i operatorëve për plotësimin e të dhënave;
39. Caktimi i një lokacioni me qira për vendosjen e masës drusore dhe pajisjeve të sekuestruara nga aktivitetet illegal;
40. Shërbimi për qiran e objektit të PK Bjeshket e Nemuna;
41. Mirëmbajtja dhe përditësimi i web aplikacioneve për mbeturina;
42. Prishja, mbyllja e rrugeve alternative në territorin e PK Sharri;
43. Shenjzimi dhe digjitalizimi i zonave të mbrojtura të natyres;
44. Ndërtimi i objektit të IHMK në parceln ekzistuese të IHMK;
45. Ndërtimi dhe Digjitalizimi i Sistemit për Monitorimin e PK Sharr (mjetet do të perdoren për projektin me Global Conservation ose ndërtimi i Qendres se Informimit- DAPK "Sharri");
46. Ndërtimi i objektit (Zyreve) në Parkun Kombetar Bjeshkët e Nemuna;
47. Rregullimi i ambienteve në vendndodhjen e objektit të IHMK (rrenimi i objektit të ish restaurantit Pellumbi, vendosja e rrethojave, rregullimi i oborrit në kubëza betoni dhe asfalt);
48. Renovimi i Objekteve të AMMK-së (Objektet e Stacioneve Meteorologjike te IHMK);
49. Rregullimi i sistemit të energjise elektrike në DAPK "Sharri".

Kanë vazhduar aktivitetet për implementimin e projekteve nga donatorët:

1. Faza e dytë e projektit për ngritjen e kapaciteteve institucionale për kontrollin e ndotjes së ajrit, i financuar nga Agjencia Japoneze për bashkëpunim ndërkombëtarë (JICA);
2. Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave me fokus riciklimin, i financuar nga Agjencia Japoneze për bashkëpunim ndërkombëtarë (JICA);
3. Projekti për menaxhimin e integruar të resurseve ujore në Kosovë, i financuar nga Qeveria Zvicerane dhe implementuar nga SKAT Consulting;
4. Projekti i bashkëpunimit në mes të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Suedisë i financuar nga SIDA Suedeze;
5. Projekti për zhvillimin e Regjistrit të shkarkimeve në mjedis (PRTR) i financuar nga Qeveria e Gjermanisë; dhe
6. Zhvillimi i aplikacionit për raportim për mbeturina i financuar nga GIZ.

1.8. Sistemi informativ mjedisor dhe baza e të dhënave

Gjate vitit 2024 sektori i Sistemit informativ mjedisor ka realizuar detyra dhe aktivitete të shumta sipas objektivave të planit të punës.

GIS dhe BDH

- Jane pranuar kërkesa të shumta për përcaktimin e vendndodhjeve të lokacioneve gjeografike si dhe janë punuar harta të ndryshme varësisht nga kërkesat:
- Mbledhja e të dhënave mjedisore dhe përgjigjeje në kërkesat për të dhëna mjedisore.
- Janë pranuar kërkesa për përcaktim të vendndodhjeve të lokacioneve gjeografike nga ana e palëve dhe janë sistemuar pas përgatitjes së përgjigjeve nga ana e SIM-it.
- Analiza gjeomatike e lokacioneve gjeografike dhe punim i hartave të veçanta tematike, për objekte dhe lokacione në raport me zonat e mbrojtura të natyrës.
- Përgatitje e raporteve ndaj kërkesave për përcaktim të lokacioneve gjeografike të objekteve dhe parcelave kadastrale në raport me Zonat e Mbrojtura të Natyrës.
- Ne kuadër të bashkëpunimit me AME është bërë procesimi i të dhënave dhe krijimi i lokacioneve gjeografike për pasqyrim në harta të veçanta tematike për qendrat korrektuese të Kosovës. Gjithashtu në proces janë harmonizimi dhe transferimi i koordinatave nga formate dhe projeksione të ndryshme në Kosova Ref01 për stacionet policore.
- Ne kuadër të bashkëpunimit me AME është bërë procesimi i të dhënave dhe krijimi i lokacioneve gjeografike për pasqyrim në harta të veçanta tematike për qendrat korrektuese të Kosovës. Gjithashtu në proces janë harmonizimi dhe transferim i koordinatave nga formate dhe projeksione të ndryshme në KosovaRef01 për urat në RKS.
- Janë Punuar Hartat Tematike për qëllime të DMMUs.
- Me kërkesë të Institutit për Mbrojtjen e Natyrës është punuar harta tematike e ndërhyrjes në ZM. Ligatina e Hencit.
- Janë Punuar Hartat Tematike për qëllime të mbrendshme të AMMKs.
- Krijimi i hartava dhe të dhënave për PK” Sharr”.
- Krijimi i hartave tematike për qëllime të MMPHIs dhe AMMKs.
- Marrja e koordinatave, procesimi i tyre si dhe punimi i hartes për ndërhyrjet në PK” Bjeshkët e Nemuna”.
- Krijimi i hartës tematike i ZMU “Liqeni i Perlepticës” ne raport me Koordinatat e marrura nga Instituti për Mbrojtjen e Natyrës.
- Procesimi i të dhënave për ndërtimet në Parkun Kombëtar Sharr dhe përgatitja e hartave.
- Pjesëmarrje në teren marrja e koordinatave dhe përcaktimi i zonës së mbrojtur strikte të Gubavicit në PK” Bjeshkët e Nemuna” si dhe punimi i hartës.
- Procesimi i të dhënave dhe krijimi i hartave tematike për raportin e mbeturinave.

- Punimi i Hartave tematike për nevoja të DMMUs gjegjësisht Komisioni për VNM dhe Pelqime Mjedisore.
- Përgatitja e hartave të deponive të mbeturinave sanitare si dhe pikave të transferit për ekipet në teren.
- Digjitalizimi i objekteve në zonën urbane të Gjilant, Klinës.
- Ka vazhduar puna për shoqërimin e fajllave të GIS –t me metodat sipas standardeve INSPIR. Gjithashtu janë shkëmbyer ide dhe forma të formateve të Metodave me ekspert të angazhuar nga keto projekte nga SEPA.
- Procesimi i të dhënave për monitorimin biologjik në tri pellgjet lumore.
- Përmirësimi i koordinatave për leje ujore 2019-2023.

-Varësisht nga nevojat, kërkesat janë përgatitur tabela të reja si dhe modifikimi i tabelave ekzistuese, mirëmbajtje të pajisjeve të teknologjisë brenda AMMKs

- Përgatitjen e tabelave me vlerat mesatare për reshje atmosferike dhe temperatura në komunat e Kosovës për vitin 2022;
- Varësisht nga nevojat, kërkesat dhe në bashkëpunim me sektorët tjerë janë përgatitur tabela të reja si dhe modifikimi i tabelave ekzistuese;
- Mirëmbajtje të pajisjeve të teknologjisë brenda AMMKs;
- Kërkesë në ASHI rreth plotësimin të informatave për krijim të usera-ve në portalin <https://environmentaldata.rks-gov.net/>;
- Konfigurim i Microsoft Teams;
- Instalim i GeoServer-it;
- Instalim i Java JDK SE 11;
- Instalim i Visual Studio Code;
- Instalim i Leaflet për vizualizimin WMS-it;
- Formatizim i PC-së dhe nxjerrje e të dhënave;
- Përgatitje e ToR (termat e referencës) dokumentit për web aplikacionet e RSHTN, Metadata XK dhe ARVM;
- Instalim i softuerëve Docker, GeoServer dhe PostgreSQL me anëtarët e kompanisë Cactus;
- Instalimi i DOCERIt dhe komplet aplikacionit për Metadata dhe është në fazën testuese nga ASHI;
- Futje e datseteve në web aplikacionin Kosovo Environmental Information;
- Mirëmbajtje e pajisjeve elektronike;
- Krijimi i listës me IP adresa për akses në Google Drive;
- Publikim i postimeve, konkurseve në webfaqen e MMPHI-së në zyrën e Informimit;
- Selektim i listës së kompanive për leje mjedisore;

- Selektim i listës së kompanive për import të biociteve;
- Përgatitja e raportit të mjedisit për vitin 2023;
- Barazim me Zyren e Financave.

Inventari i gazrave serrë, GHG

Në kuadër të Inventarit të Gazrave Serrë ka vazhduar me:

- Plotësimin e softuerit IPCC 2006 më të dhëna 2000-2023;
- Plotësimi i tabelave timeseries për energji për vitin 2023;
- Plotësimin e softuerit IPCC 2006 me të dhëna 2023; dhe
- Instalimi i softuerit IPCC 2006 në PC dhe krijimi i strukture së derivative në sektorin e energjisë.

1.9. Pjesëmarrja në grupe punuese dhe komisione ministore dhe ndërministrore

Stafi i DVGJM, ka marrë pjesë **në grupe punuese dhe komisione ministore dhe ndërministrore.**

Disa nga aktivitetet më kryesore të realizuara gjatë vitit 2024 janë:

- Vendim i AKK për Grup punues për mardhënie me publikun, dhe komunikim për zbatimin e UA MMPHI Nr.10/2023 për përbërjen, fushëveprimtarinë, dhe mënyrën e funksionimit të Grupeve punues për Infrastrukture Kombëtare të Infoirmacionit Mjedisor;
- Vendimi i Ministrit për Task Forcen e Gjelbërt;
- Pjesëmarrja në grupin punues për Rregullore për Organizim dhe sistematizim të vendeve të Punës në AMMK;
- Pjesëmarrja në grupin punues për hartimin e arsyeshmërisë profesionale për Rrjedhën e Lumit Mirusha.
- Pjesëmarrja në grupin punues për përpunimin e të dhënave të menaxhimit të Mbeturinave;
- Pjesëmarrja në grupin punues për hartimin e Raportit për gjendjen e mbeturinave në Kosovë;
- Pjesëmarrja në grupin punues për Koncept Dokumentin për Mbeturina;
- Pjesëmarrja në grupin punues për hartimin e Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës;
- Pjesëmarrja në grupin punues për hartimin e Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Pjesëmarrja në grupin punues për Ndryshim Plotësimin e Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore;
- Pjesëmarrja në Këshillin Organizativ sipas Vendimit të SP-MMPHI Nr.Prot. 3506/2024, i dt.29.05.2024 për formimin e Këshillit Organizativ për organizimin e shënimit të 5 Qershorit “Dita Ndërkombëtare e Mjedisit;

- Pjesëmarrja në Këshillin Organizativ sipas Vendimit të SP-MMPHI Nr.Prot. 2341/2024, i dt.05.04.2024 për formimin e Këshillit Keshill Organizativ për organizimin e shënimit të 22 Prillit “Ditët Botërore të Tokës”;
- Pjesëmarrja në Këshillin Organizativ sipas Vendimit të SP-MMPHI për formimin e Këshillit Organizativ për organizimin e shënimit të Dites së Meterologjisë dhe Ujërave;
- Pjesëmarrja në Këshillin Organizativ sipas Vendimit të SP-MMPHI për formimin e Këshillit Organizativ për shënimin e Ditës Ndërkombëtare Pa Makina dhe EMW 16-22 shtator 2024;
- Pjesëmarrja në Këshillin Organizativ sipas Vendimit të SP SP-MMPHI për formimin e Këshillit Organizativ për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit;
- Pjesëmarrja në Këshillin Organizativ sipas Vendimit të SP SP-MMPHI për formimin e Këshillit Organizativ për shënimin e Ditës Ndërkombëtare për Zona Urbane;
- Pjesëmarrja në Këshillin Organizativ sipas Vendimit të SP SP-MMPHI për formimin e Këshillit Organizativ për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Maleve;
- Pjesëmarrja në Këshillin Organizativ sipas Vendimit të SP SP-MMPHI për formimin e Këshillit Organizativ për shënimin e Ditës Botërore e Ecjes së Lirë;
- Pjesëmarrja në Këshillin Organizativ sipas Vendimit të SP SP-MMPHI për formimin e Këshillit Organizativ për shënimin e Ditës së Biodiversitetit;
- Pjesëmarrja në Këshillin Organizativ sipas Vendimit të SP SP-MMPHI për formimin e Këshillit Organizativ për shënimin e Ditës së Parqeve Evropiane;
- Pjesëmarrja në Komisionin për Organizimin e Dhënies së Provimit Profesional për Mbikëqyrës të Zonave të Mbrojtura;
- Pjesëmarrje në Grupin Punues për Arsyeshmëri profesionale për Rrjedhjen e Lumit Mirusha si dhe harmonizimin e vendimit me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës;
- Pjesëmarrje në komisionin për vlerësim “Shenjezimi dhe digjitalizimi i zonave të mbrojtura të natyrës”;
- Pjesëmarrje në komisionin për pajisje teknologjike;
- Pranimi dhe shpërndarja e materjaleve të ITs sipas kontratës;
- Pjesëmarrje në komisionin për bvlërësim për mirëmbajtje te Regjistri i ndotësve;
- Pjesëmarrje në komisionin vlerësim për pajisje teknologjike minitender;
- Pjesëmarrje në komisionin për Leje Mjedisore;
- Pjesëmarrje në komision për blerjen e pajisjeve teknologjike;
- Pjesëmarrje në komision për pranimin e materialeve sipas kontratës “Shtypja e Materialeve për nevojat e MMPHI-së dhe AMMK-së”;
- Pjesëmarrje në komision për pranim për kontratën “Blerjen e tendave me pajisje përcjellëse për :Kampi i Astronomise 2023: Brod, Dragash;
- Menaxher i kontratës furnizimeve me Kontejner LOT 2 në bazë të kontratës:RI-TENDER; Skema mbështetëse për mbeturina në Kosovë- Furnizim me kamion, Eskavator, Kontenjer dhe Autofshisa;

- Pjesëmarrje në komision për pranim për kontratën “Ritender Kërkesë për blerjen e drunjtëve dhe kopshteve vertikale me rastin e shënimit të festave mjedisore sipas kalendarit mjedisor;
- për pranim për kontratën “ per material shpezues ne kuadter te konartes se AQP;
- Menaxher i projektit - kontrates për Pastrimin dhe mirëmbajtjen e zyrave të AMMK;
- Menaxher i Kontratës; Angazhimin e një kompanie për sigurimin fizik te objektit, pajisjeve dhe masës drusore te sekuestruar ne Prizren;
- Menaxher i kontratës “Mirëmbajtja dhe azhurnimi e web faqes AMMK dhe IHMK;

1.10. Pjesëmarrja në trajnime, seminare dhe punëtori

Stafi i DVGJM, ka marrë pjesë në trajnime , seminare, punëtori, dhe ngjarje të ndryshme të cilat shumica kanë qenë të organizuara online. Këto trajnime dhe aktivitetet tjera kanë ndikuar në ngritjen e njohurive për fushat përkatëse. Këto aktivitete kanë qenë të mbështetura nga institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Disa nga aktivitetet më kryesore të realizuara gjatë vitit 2024 janë:

- Pjesëmarrja në punëtori në kuadër të projektit të JAICA për ngritjen e kapaciteteve për kontrollin e cilësisë së ajrit;
- Pjesëmarrja në takimet e rregullta online të organizuar nga EIONET/EEA-së, për NRC e zhurmës, ekonomisë qarkore, mbeturinave, ujrave, shëndeti etj;
- Pjesëmarrja në takimin punës në kuadër të projektit për avancimin e sistemit të menaxhimit dhe raportimit për mbeturina i mbështetur nga GIZ;
- Takime pune në kuadër të grupit teknik për verifikimin e të dhënave të raportuara nga komunat për raportin e menaxhimit të mbeturinave komunale për vitin 2022;
- Pjesëmarrja në punëtoritë e organizuara në kuadër të projektit: "Ngritja e kapaciteteve per përdorimin e të dhenave mjedisore" - SEPA-AMMK;
- Pjesëmarrja në punëtoritë për Strategjinë e Zhvillimit Institucional/Analiza Funksionale organizuar nga SKAT;
- Pjesëmarrje në punëtorinë “ADAPT” për pilot projektin e L.Erenik në Gjakovë.
- Pjesëmarrje në punëtorinë rajonale organizuar nga TRATOLOW: " Përtej zhvillimit të NECP-ve – çfarë duhet të bëhet pasi të miratohen planet.";
- Pjesëmarrje ne punëtorinë rajonale organizuar: TAIEX TRATOLOW Regional workshop on technologies to tackle the Climate Change;
- Pjesëmarrje ne punëtorinë teknike për udhëzimin administrativ për gazrat serre Technical Workshop on the Administrative Instruction on GHG emissions;
- Pjesëmarrje ne punëtorinë për hartimin e Planit të Përformancës së AMMK për vitin 2025’
- Pjesëmarrje ne punëtorinë për hartimin e Planit te punës 2025, Raportit te punës 2024 dhe Planit të buxhetit 2025;
- Pjesëmarrja në punëtorinë për barazinë gjinore në menaxhimin e mbeturinave;

- Trajnim për Gjeodatabazën dhe Gjeoportalin e SIU në SKAT;
- Trajnim i komunave për sistemin “Raportim për Menaxhimin e Mbeturinave” 4-7.03.2024 Istog;
- Trajnim portalin Metadata nga Keitaro;
- Trajnim për Gjeodatabazën dhe Gjeoportalin e SIU në SKAT;
- Fillimi i trajnimit në SCAT për platformën ESRI (ArcGis Pro);
- Pjesëmarrje në trajnimim për Vlerësimin Strategjik Mjedisor;

1.12. Ngecjet dhe problemet

Gjatë realizimit të planit të punës dhe aktiviteteve sipas planit të punës DVGJM ka hasur edhe në ngecje dhe probleme.

Per të tejkaluar keto pengesa do të duhej që MMPH/AMMK të perkrah dhe të fuqizojë DVGJM me ngritje të kapaciteteve humane përmes:

- Përgatitjes dhe aprovimit të Rregullores për organizim dhe sistematizimin e vendve të punës në AMMK;
- Sistematizimit të zyrtarëve në AMMK;
- Plotësimi i pozitave të lira në Drejtori;
- Shtimit të numrit të zyrtarëve në DVGJM për disa fusha që nuk janë të mbulura.

2. Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

IHMK është i organizuar në 4 sektorë, dhe në vijim janë listuar aktivitetet e realizuar për secilin sektorë ndaras.

1. Sektori i Hidrologjisë

Aktivitetet e realizuara:

- Monitorimi i rregullt hidrologjik, i të gjitha stacioneve hidrometrike, sipas dinamikës së planifikuar dhe kushteve tjera specifike;
- Monitorimi i puseve të Ujërave nëntokësorë (40);
- Kontrolli i niveleve të ujërave nëntokësorë me pajisjet matëse;
- Marrja në mënyrë manuale e të dhënave të regjistruara nga sensorët në puset e ujërave nëntokësorë;
- Matjet gjeometrike me pajisje, të profileve hidrometrike (ku janë vendosur sistemet e kamerave);
- Matjet rrjedhave dhe profileve hidrometrike me pajisjet: RiwerPro, ADCP, F1, M1;
- Monitorimi dhe kontrollimi i rregullt teknik i pajisjeve hidrometrike në instaluar në terren;
- Kalibrimin e pajisjeve të instaluar (sensor/nivelmatës) – korespondimi i tyre;
- Konfigurimin e sistemit (senzorëve dhe softuerve);
- Matje hidrometrike në disa profile hidrometrike;
- Zhvendosja e stacionit hidrometrik (të gjitha pajisjeve të instaluar) në Lluzhan (Lumi Llap), shkaku u i ndërtimit të urës;
- Sistematizimi dhe kontrollimi kualitatit i të dhënave) – Baza e të dhënave (meteo, hidro, kualitetit të ujit;
- Përgaditja e vjetarit hidrometeorologjik për IHMK – 2023;
- Përgaditja e njoftimeve (për veërshime/përmbytje);
- Përgaditja e raporteve dhe informacioneve tjera për ëeb faqen fb e IHMK;
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave prej disa bashkëpunorëve në terren;
- Sistematizimi i të dhënave të reshjeve dhe përgaditja e tyre në formatin e duhur për tu futur në bazën e të dhënave;
- Përgaditja dhe rregullimi i lakoreve nga matjethidrometrike) të rregullta dhe të veqanta;
- Përgaditja e të dhënave sipas kërkesave specifike nga palët dhe institucionet;
- Përgaditja e të dhënave për Platformën Pacifik Disaster Aëare (PDC);
- Përgaditja dhe komunikimi i rregullt me European Flood Aëareness System (EFAS);
- Përgaditja e të dhënave për Standard Precipitation Index (SPI);
- Përgaditja dhe integrimi i të dhënave për projektin e JICA, për yjarret pyjore (NFFS).

Pjesëmarrja në trajnime, seminare dhe punëtori

Stafi i sektorit të hidrologjisë, ka qenë pjesë aktive nga projekti IPA-FF, i cili ka zgjatur 3 vite, duke marrë pjesë në të gjitha komponentet e saja, në puntori, trajnime, vizita studimore etj. Po ashtu ka marrë pjesë aktive në disa prej strategjive dhe planeve të punës të organizuara nga Ministrinë dhe institucione të ndryshme.

- Pjesëmarrje në puntorit dhe trajnimet të organizuara nga IPA – FF;

- Pjesëmarrje në kuadër të MMPH, si pjesë e aktiviteteve për hartimin e strategjisë së Ndryshimeve Klimatike;
- Pjesëmarrje në hartimin e Strategjisë së Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm;
- Pjesëmarrje në grupet punuese dhe këshilldhënëse për Hartimin e Hartave të Rrezikut ndaj Vërshimeve;
- Pjesëmarrje në Sekretariatit e Ndryshimeve Klimatike në MMPH;
- Pjesëmarrje në komunitetin e Thatësirave (Monitorimi i Thatësirës dhe Paralajmërimi i Hershëm) me organizata dhe palë të ndryshme të interesit;
- Pjesëmarrje në grupin punues për organizimin e Ditës së Meteorologjisë dhe të ujit në IHMK;
- Projekti IWRM-K, Planet dhe Strategjia e zhvillimit të IHMKs;
- Pjesëmarrje në kuadër të projektit EU4 Green;
- Puntori për SPEI, nga SlovakAid, me SHUKOS dhe kompani të ujësjellësve rajonal;
- Puntori e organizuar nga SIDA (krijimi i aplikacionit);
- Punëtori – diskutim publik, për ndërtimin e digës së Dragaqinës;
- Puntori për rreziqet me karakter hidroklimatik, me NATO/KFOR;
- Puntori, Change for Climat, organizuar nga USAID/ADAPT;
- Puntori "Zhvillimi i Konceptit të Projektit për Zbatimin e Zgjedhjeve të Bazuara në Natyrë", prganizuar nga ADAPT;
- Dialogu Kombëtarë për Thatësirat, Slovak Aid;
- ETC – CA, Assessment of Climate Change Adaption Policy Frimeëorks in Europe;
- IPA –FF, Multi Contry Study, Pellgu i Lepencit;
- Puntori "Udhërrëfyesi i tranzicionit në Komunën e Obiliqit, organizuar nga GIZ;
- International Conference on Environmental Sustainability and Climate Change, organizuar nga USAID;
- Puntori organizuar nga USAID, Zhvillimi i Metodologjive për cënueshmëri nga Ndryshimet Klimatike;
- EËG, në kuadër të prijektit DRIN CORDA;
- Menaxhimi i Zjarreve Pyjore, organizuar nga AME;
- Konferenca e Përbashkët Ballkanike, Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimaterike: Menaxhimi i Mungesës së ujit, Thatësirave dhe Përmbytjeve në Ballkanin Perëndimor, organizuar nga SHUKOS/SHUKALB.

Projektet e Zhvilluara

- Blerja e Pajisjeve Hidrologjike për Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës (Hydrological Equipment for Hydrometeorological Institute of Kosovo). FLOWS, Banka Botërore. – financuar përmes kredisë;
- Mbështetje për pajisje meteorologjike (Stacion Automatik Meteorologjik dhe Shimatës Automatik), projekti IWRM – K nëpërmjet SKAT;

- Shtimin e 12 stacioneve automatike të matjes së reshjeve, projekti i financuar nga Asociacioni për zhvillim Rural (Associates in Rural Development, INC – Dega në Kosovë (Tetra Tech ARD), Kontraktor Kryesor për projektin USAID Kosovo Adapt Activity;
- Mirëmbajtja dhe Servisimi i pajisjeve të rrjetit hidrometrik të Ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësor.

2. Sektori i Meteorologjise

Aktivitetet e realizuara:

- **Matjet e rregullta klimatologjike në terminet e caktuara (7:00, 14:00, 21:00):**
 - Matja e temperaturës së ajrit 2m mbi nivelin e tokës;
 - Matja e temperaturës minimale dhe maksimale;
 - Matja e lagështirës së ajrit në tri termine;
 - Matja e presionit atmosferik në tri termine;
 - Matja e shpejtësisë, forcës dhe drejtimit të erës në tri termine dhe jashtë termineve në raste ekstreme;
 - Matja e temperatures ekstreme 5cm mbi nivelin e tokës;
 - Matja e temperatures 50 dhe 100cm nën nivelin e tokës;
 - Matja e sasisë së reshjeve në mm;
 - Matja e trashësisë së dëborës;
 - Matja e shkëlqimit të diellit (Insolacioni).

Përcaktimi i Fenomeneve Të Tjera Klimatike:

- Përcaktimi i vranësirave dhe lartësisë (lloji dhe nënloji i tyre)
- Përcaktimi i pikës së vesës;
- Përcaktimi i dukshmërisë horizontale;
- Vëzhgimi i gjendjes së tokës;
- Vëzhgimi i mjegullës dhe përcaktimi i llojit të mjegullës;
- Të mbuluarit e qiellit me re (vrenjtësia);
- Avullimet.

Matjet Klimatologjike dhe Parashikimet:

- Realizimi i matjeve klimatologjike në termine të caktuara kohore, në përputhje me rregullat e WMO-së;
- Realizimi i parashikimeve të motit (javore dhe për fundjavë).

Komunikimi dhe Intervistat:

- Intervistat e rregullta dhe prononcimet për mediat lidhur me gjendjen meteorologjike në periudha të ndryshme gjatë vitit;

- Raportimi i gjendjes së motit në institucione relevante, kur është kërkuar ekspertizë profesionale.

Përkujdesja për Stacionet Meteorologjike:

- Vizitat në terren në stacione meteorologjike manuale dhe automatike;
- Intervenimet teknike për mirëmbajtjen e stacioneve meteorologjike, duke siguruar funksionimin e rregullt të tyre në terren;
- Kalibrimi dhe mirëmbajtja teknike e instrumenteve meteorologjike.

Projekte dhe Iniciativa:

- Pjesëmarrja në projektin "Avancimi i Rrjetit Hidrometeorologjik në Kosovë," duke monitoruar punimet dhe implementimin e këtij projekti.

Përgatitja e Raporteve dhe Analizave:

- Përgatitja e raporteve për mediat e shkruara.
- Formulimi i përgjigjeve për kërkesat e qytetarëve, të dërguara përmes email-it.
- Evidentimi i të dhënave meteorologjike në databazë.
- Përgatitja e analizave dhe statistikave të ndryshme meteorologjike.
- Përgatitja e të dhënave meteorologjike për vjetarin hidrometeorologjik.

Pjesëmarrja në Takime dhe Bashkëpunime:

- Pjesëmarrja në takime zyrtare me institucione të tjera vendore, qeveritare dhe joqeveritare.
- Takime me SKAT, për diskutime dhe punime të orientuara drejt fuqizimit të rrjetit hidrometeorologjik në Kosovë.

3. Sektori i Monitorimit të Cilësisë së Ajrit

Aktivitetet e realizuara:

1. Planifikimi dhe Organizimi:

- Planifikimi i kërkesave për materialin e nevojshëm për mirëmbajtjen e pajisjeve në SMCA matëse të cilësisë së ajrit;
- Organizimi i punëve me bashkëpunëtorët e angazhuar në projekte të ndryshme me donatorë si: JICA, SEPA, EU4Green, EEA/EIONET, MCC etj.

2. Mbikëqyrja e Procesit të Monitorimit dhe Mostrimit:

- Monitorimi i cilësisë së ajrit në tërë territorin e Kosovës përmes 13 stacioneve fikse dhe një stacioni mobil në Prishtinë;

- Matjet e emisioneve në kompani publike dhe private nga stafi i trajnuar në IHMK;
- Mbikëqyrja dhe menaxhimi i kontratës për mirëmbajtjen dhe servisimin e stacioneve për monitorimin e cilësisë së ajrit, “Furnizimi dhe Mirëmbajtja e Rrjetit të Stacioneve për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit”.

3. Raportimi i Rezultateve:

- Përpunimi dhe paraqitja e të dhënave të mbledhura nga matjet e cilësisë së ajrit në formë tabelore dhe grafike;
- Përgatitja e raporteve mujore dhe vjetore për cilësinë e ajrit;
- Raportimi vjetor në EEA për Data Flow D dhe Data E1a;
- Përgatitja e raporteve të veçanta sipas kërkesave.

Përfaqësimi në implementimin e projekteve:

1. Projekti i JICA "Zhvillimi i Kapaciteteve për Kontrollin e Ndotjes së Ajrit" Faza e Dytë:
 - Mostrimi i cilësisë së ajrit me pompë me vëllim të ulët (per analizën e metaleve te renda ne ajër);
 - Dërgimi i informatave lidhur me SMCA;
 - Komponenta e ndarjes së kontributeve të burimeve PM”, kemi përfunduar mostrimin e cilësisë se ajrit në Prishtinë me pajisjen SLIT JET MURATA, ku pastaj mostrat janë analizuar ne Japoni;
 - Trajnim ne Japoni për analizën e ndotjes se ajrit bazuar ne matjet e cilësisë se ajrit, me fokus ne Studimin e ndarjes se kontributit te burimeve te PM;
 - Dërgimi i raporteve për JICA ne baza Mujore ne kuadër te komponentës se Cilësisë se ajrit;
 - Trajnim për analizën e metaleve te renda ne ajër ne laboratorin e IHMK-se;
 - Pjesëmarrje e vazhdueshme ne Takime –Workshope.
2. Projekti EU4Green - Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor:
 - Pjesëmarrje ne Workshopet dhe takimet e organizuara;
 - Përgjigje dhe komente ne kuadër te këtij projekti.
3. Projekti "Ndërtimi i Kapaciteteve mbi Përdorimin e të Dhënave Mjedisore në Kosovë":
 - Pjesëmarrje ne Workshopet e organizuar;
 - Përgjigje dhe komente ne kuadër te këtij projekti.
4. Pjesëmarrja në takimet dhe workshopet e organizuara nga SEPA në kuadër të programit: “Partnership for Improving Air Quality in the Western Balkans”

Aktivitete të tjera:

- Kontrolli ditor i SMCA në lokacione të ndryshme;
- Kontrolli i gjendjes funksionale të monitorëve për informimin e publikut me CA;
- Hartimi i listës së furnizimeve për vitin 2024;
- Përgatitja e raporteve për ajër sipas kërkesave të komunave, mediave dhe institucioneve vendore dhe ndërkombëtare;
- Pjesëmarrja në grupin punues për hartimin e Strategjisë së Mjedisit dhe në Udhëzimin Administrativ për metalet e rënda në ajër etj.
- Pjesëmarrje në grupin punues për hartimin e Strategjisë Afatgjate për Dekarbonizim;
- Pjesëmarrje në grupin punues për hartimin e U.A. për caktimin e përmbajtjes, metodologjisë dhe përputhshmërisë së raportit me kërkesat ligjore, praktikat e zbatueshme dhe aspektet e tjera teknike të raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis;
- Pjesëmarrja në grupet punuese për përgatitjen e raportit të performancës së AMMK-se, ku është përgatitur raporti i performancës për IHMK;
- Pjesëmarrje në grupin punues të inventarit të gazrave serë;
- Janë monitoruar parametrat ndotës të ajrit: SO₂, NO_x, CO, O₃ dhe grimcat PM₁₀/PM_{2.5}, si dhe parametrat meteorologjik në 12 stacione fikse monitoruese dhe një stacion mobil;
- Arkivimi i të dhënave të mbledhura nga stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit, kontrolla, validimi dhe përpunimi i tyre;
- Raportimi përmes sistemit online në kohë reale dhe në baza ditore, mujore dhe vjetore për cilësinë e ajrit;
- Përpunimi i të dhënave nga monitorimi i cilësisë së ajrit për këta parametra: PM₁₀, PM_{2.5}, SO₂, CO, NO₂, NO, O₃ dhe parametrat meteorologjik;
- Paraqitja në formë tabelore dhe grafike dhe përpunimi i tyre në baza ditore, mujore dhe vjetore;
- Komentimi i të dhënave të mbledhura për cilësinë e ajrit;
- Përgatitja e raporteve ditore, javore, mujore dhe sipas kërkesave për cilësinë e ajrit dhe publikimi në web dhe Facebook;
- Përgatitja e raporteve për ajrin sipas kërkesave (Komunat, Mediat dhe Institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare);
- Raportimi në EIONET-EEA, raporti për Data Flow D, raporti vjetor E1a dhe kontrolla ditore e rrjedhjes së të dhënave nga stacionet në web të EEA për Indeksin e Cilësisë së Ajrit të Evropës;
- Matjet e emisioneve në oxhaqet e KEK-ut, sipas kërkesave të projektit të JICA-s (nga stafi i trajnuar);

- Vrojtimi i implementimit të projektit me titull “Mirëmbajtja e Aplikacioneve për Cilësinë e Ajrit dhe Informimi i Publikut për Parashikimin Treditore të Cilësisë së Ajrit” (<https://airqualitykosova.rks-gov.net>);
- Komunikimi me media dhe institucioneve vendore dhe ndërkombëtare për cilësinë e ajrit;
- Organizimi i punëve për projektet që lidhen me fushën e ajrit.

4. Sektori i Cilesise së Ujerave

Marrja e mostrave të ujit në lumenjtë e Kosovës dhe në ujërat e shkarkuara nga burime te ndryshme ndotëse, sipas planit të punës së IHMK, kërkesave të ministrisë dhe institucioneve tjera, kërkesave nga bashkëpunimi me projektet, si ne vijim:

- Ujera sipërfaqësor: 453 mostra nga to 44 burime te lumenjve (deri me 18.12.2014)
- Ujerat Nëntokësorë: 35 në të gjitha pellgjet lumore;
- Sipas kërkesave të Inspektoratit të MMPHI: 15 mostra;
- Nga projektet: 12 Mostra ne Lumenjtë e pellgut te Drinit te Bardh të cilat janë analizuar në Laboratorët e Suedisë projekt i financuar nga SEPA:
- 35 Mostra në rrjetin e monitorimit te cilësisë se ujerave nëntokësorë ne 4 pellgjet lumore te analizuar ne Laborator te jashtëm te akredituar me ç ‘rast janë analizuar metalet e renda në të gjitha mostrat dhe ne 14 mostra janë bërë edhe analiza e Pesticideve, Bifenileve të Poli Klorinuar dhe Hidrokarburet Poli Aromatike;
- 56 mostrat ne rrjetin e monitorimit të cilësisë së Ujerave sipërfaqësorë ne 4 pellgjet lumore po ashtu te analizuar në laborator të jashtëm të akredituar me ç ‘rast janë analizuar metalet e renda ne te gjitha mostrat dhe ne 14 mostra janë bere edhe analiza e Pesticideve, Bifenileve te Poli Klorinuar dhe Hidrokarburet Poli Aromatike.

Analiza fiziko –kimike e mostrave të ujit, numri i parametrave te përcaktuar dhe shpeshtësia:

- Fiziko kimike 24 parametra në secilën mostër te lumenjve dhe ujerave te shkarkuara për çdo muaj;
- Fiziko kimike 50 parametra në ujërat e burimeve të lumenjve dhe atyre nëntokësorë dy here në vite;
- Sipas kërkesave me nr. Të ndryshëm te parametrave.

Mirëmbajtja e pajisjeve portabel për matjen e parametrave fiziko-kimik në ujë , shpeshtësia e kalibrimit dhe testimit te tyre:

- Përgatitja e rregullt e pajisjeve për mostrim në terren;

- pH metrin me dy tretje buferike;
- Testimi para çdo dalje në teren i Konduktometrit si dhe kalibrimi një herë në javë;
- Testimi dhen kalibrimi i Oksigjenometerit para çdo leximi;
- Kalibrimin e peshoreve është bere 1 here ne 6 muaj ndërsa testimi i tyre para fillimit te çdo matje;
- Testimi i rregullt i enëve vëllimetrike: pipetave, mikropipetave dhe byretave digjitale;

Kalibrimi dhe testimi i pajisjeve për analiza fiziko-kimike të ujrave sipërfaqësorë:

- Turbidimetri është kalibruar çdo here para fillimit të matjeve sepse stabiliteti i tije nuk ka qendrushemeri afatgjate;
- Spektrofotometri WTW 6600 nje dy here në muaj;
- Spektrofotometri PASTEL UV dy here në muaj;
- Spektrofotometri Masheroy and Nagel është bere testimi një herë në muaj;
- Ion Kromatografi kalibrohet per dynivele koncentrimesh të mostrave, ndërsa testohet pas leximit të çdo 5 mostre;
- Kromatografi i Gazte me Mase Spektrometer i është kryer servisimi dhe është në funksion;
- ICP-MS- është rregulluar dhe është i gatshëm për përdorim, për çka kërkohet të mbahen trajnime.

Arkivimi i te dhënave të mbledhura nga monitorimi, validimi dhe përpunimi i tyre:

- Janë arkivuar dhe regjistruar të dhënat e terrenit në regjistrator përkatës;
- Rezultatet e analizave laboratorike, janë ruajtur në hard copy dhe në tabela Excel;
- Rezultatet e analizave laboratorike janë raportuar edhe në EEA/EIONET

Akreditimi i Labororit me ISO17025:2018:

- Është arrit qe laboratori për monitorim të cilësisë së ujtë të marre certifikatën e Akreditimit me Nr. LT120 sipas standardit ISO 17025:2018 për laboratorë, nga Drejtoria për Akreditim të Kosovës

Përgatitja e raporteve laboratorike për kërkesat e Inspektoratit Mjedisor te MMPH dhe institucioneve tjera:

- Përgatitja e raporteve për çdo mostrim që është ardhur sipas kërkesave të Inspektoratit Mjedisor nga MMPHI, Inspektorateve Komunale dhe nga institucione tjera;
- Përgatitja e raporteve për projektet të cilat kanë kërkesa për monitorim të;
- Raporti mbi gjendjen e ujerave përgatitet një here në vite në bashkëpunim me DVGJM/AMMK;
- Raportimi në EIONET, raporti për emisionet në ujë;
- Është përgatitur Raportimi për Emisionet në ujë për Impiantin për Trajtimin e Ujerave të Zeza në Skenderaj.

Pjesëmarrja në punëtori dhe seminare jashtë vendit, numri i vizitave dhe tematika

- Zvicër, për marrëveshjet ndërkufitare për ujë;
- Japoni, për mbrojtjen e ajrit nga ndotja (JICA);
- Kroaci, për të parë nga afër menaxhimin e ujerave në shtetin Kroat;
- Gjermani, për të parë nga afër pajisjet për matjen e rrezatimit radioaktiv të cilat pastaj janë vendosur në disa lokacione të Kosovës;
- Gjermani, për të parë nga afër prodhimin e pajisjeve Meteorologjike Hidrologjike dhe senzoret për përcaktimin e disa parametrave të cilësisë së ujit;
- Mal të Zi, vizitë në laboratorin e akredituar për përcaktimin e parametrave organik në mostrat e ujit;
- Itali, trajnim i një zyrtari nga stafi mbështetës i MIRU-K (SKAT) për përcaktimin e parametrave organik në mostrat e ujit;
- Kosovë punëtori në lidhje me orientimin e zhvillimit afatgjatë të IHMK-s, organizuar nga SKAT;
- Mal të Zi, për direktivën e Nitrateve;
- Kosovë, për monitorimin e Ujerave sipas DKU;
- Shqipëri, vizite në Laborator të akredituar për përcaktimin e parametrave inorganik të ujit, me theks të veçantë metalet e rënda;
- Austri, për mbrojtjen e ujerave nëntokësore nga ndotja prej aktiviteteve bujqësore;
- Pjesëmarrja në grupet punuese për hartimin e dokumenteve dhe në projekte ndërmministrorë;
- Koordinimi i grupit tematik për laborator në kuadër të projektit me JICA: “Ngritja e kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit”;
- Pjesëmarrja në takime në grupin këshillëdhënës për Standarde Ndërkombëtare në kuadër të Agjencionit për Standarde;
- Takim pune në lidhje me zhvillimin institucional të menaxhimit të integruar të burimeve të ujit në Kosovë për projektin “MENAXHIMI I INTEGRUAR I BURIMEVE TË UJIT NË KOSOVË” (IWRM-K), 2 takime;

- Mbajtja e dy trajnimeve të stafit të KEK-A dhe KEK-B për përdorimin e pajisjeve për matjen e emisioneve në ajër;
- Pjesëmarrja në grupin punues për përgatitjen e dokumentacionit për Akreditimin e Laboratorëve për Monitorim të Cilësisë së Ujerave

Projekt propozimet e përgatitura për donatore

- Furnizimi i laboratorit me pajisje laboratorike për monitorim të cilësisë së ujerave si me HPLC, GC-MSMS- ICP-MS, Pajisje për TOC, NT, pajisje për përcaktimin e Hg.

Aktivitete tjera shtese ne IHMK

- Menaxher i Cilësisë për Akreditimin e Laboratorit të Monitorimit të Cilësisë së Ujti me ISO 17 025:2018;
- Koordinator i Grupit të Laboratorit për matjen e metaleve të rënda në ajër (JICA);
- Kalibrimi i analizërit automatik për matje të emisioneve;
- Matja e emisioneve në ajër në KEK dhe disa kompani tjera private në kuadër të projektit me JICA;;
- Mostrimi për emisionet në ajër dhe analizimi i mostrave të tilla në laborator;
- Mineralizimi i mostrave të ngurta;
- Përgatitja e mostrave për përcaktimin e anioneve me Ion Kromatograf;
- Llogaritjet e ndryshme në terren dhe laborator për matjet e emisioneve në ajër;
- Përgatitjen e një mori tretjesh për kryerjen e përcaktimit të parametrave në mostrat të ujerave të sjella në laborator;
- Përgatitjen e tretjeve standarde;
- Aktivitete të ndryshme me praktikant gjatë praktikës së tyre në sektorin e monitorimit të cilësisë së ujerave në IHMK;
- Pritja dhe prezantimi i punës së IHMK dhe posaçërisht sektorit për monitorimin e cilësisë së ujerave grupe nxënësish dhe studentë.

3. Instituti i Kosovës për Mbrojtjes e Natyrës

Gjatë vitit 2024 mbrojtja e natyrës është realizuar përmes Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Përkundër mungesës së stafit (vetëm 2 zyrtarë), gjatë vitit 2024 janë realizuar aktivitete të shumta dhe detyra sipas objektivave të planit të punës dhe dokumenteve tjera relevante. Aktivitetet dhe veprimet kryesore kanë qenë të fokusuara kryesisht në monitorimin e zonave të mbrojtura dhe biodiversitetin, evidentimin e zonave të reja të natyrës, hartimin e studimeve dhe procedimin për marrjen nën mbrojtje ligjore, dhënien e mendimeve profesionale për aktivitetet në zonat e mbrojtura të natyrës si dhe realizimin e projekteve për mbrojtjen e natyrës.

Në këtë raport janë prezantuar vetëm disa nga të arriturat kryesore të IKMN-së, rezultatet si dhe gjeçjet në realizimin e detyrave të punës.

1. Monitorimi i gjendjes së zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit

Gjatë vitit 2024, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) me qëllim të monitorimit të gjendjes së zonave të mbrojtura dhe biodiversiteti, ka realizuar vizita të shumta terreni në zonat e mbrojtura dhe ka përgatitur raporte për gjendjen e këtyre zonave, në veçanti janë dhënë përgjigjet profesionale, për ndërhyrjet e bëra në këto zona dhe ndikimet në biodiversitet në përgjithësi, ku janë evidentuar problemet aktuale si dhe janë rekomanduar masat për tejkalimin e tyre.

Edhe gjatë këtij viti, edhe pse me pengesa të mëdha të stafit, ka vazhduar të bëhet monitorimi i faunës më anën e kamerave kurth në dy Parqet Kombëtare, “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna” me ç’rast janë evidentuar një numër i llojeve të rralla të shtazëve të egra që në përgjithësi pasqyrojnë gjendjen e kënaqshme në të dy Parqet Kombëtare, (te cilat janë publikuar kohe pas kohe në ëb-në e AMMK-së).

Janë monitoruar kryesisht zonat mbrojtura me vlera të veçanta natyrore si: Rezervatet strikte, Parku Kombëtar “Sharri”, Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, MNRV” Shpella e Gadimës” dhe “Ujëvarat e Mirushes”, Peizazhi i Mbrojtur “Gërmia”, Bifurkacioni i Lumit Nerodime, Gryka e Rugovës, Burimi i Drinit të Bardhë, Kanioni i Drinit të Bardhë të Ura e Fshejtë” si dhe shumë zonat tjera të mbrojtura.

Gjatë këtij viti janë monitoruar edhe zonat tjera të mbrojtura:

- Janë realizuar dy vizita në terren në zonën e veçantë të mbrojtur “Ligatina e Hencit”
- Realizimi i dhjetë vizitave monitoruese në PK “Bjeshkët e Nemuna”.
- Realizimi i vizitës monitoruese të vlerave natyrore në territorin e komunës së Deçanit në kuadër të Komisionit për verifikimin dhe pranimin e punimeve për projektin “Shenjëzimi dhe digjitalizimi i zonave të mbrojtura të natyrës”.

- Realizimi i vizitës në terren për monitorimin e vlerave natyrore në territorin e komunës së Gjakovës në kuadër të Komisionit për verifikimin dhe pranimin e punimeve për projektin “Shenjëzimi dhe digjitalizimi i zonave të mbrojtura të natyrës”.
- Realizimi i vizitës monitoruese në monumentet e natyrës në territorin e komunës së Ferizajit pas realizimit të projektit “Shenjëzimi dhe digjitalizimi i zonave të mbrojtura të natyrës”: Me këtë rast janë vizituar 13 vlerat e trashëgimisë natyrore në territorin e komunës së Ferizajit.
- Realizimi i vizitës monitoruese në monumentet e natyrës në territorin e komunës së Gjilanit pas realizimit të projektit “Shenjëzimi dhe digjitalizimi i zonave të mbrojtura të natyrës”: Me këtë rast janë vizituar 13 vlerat e trashëgimisë natyrore në territorin e komunës së Gjilanit.
- Realizimi i vizitës monitoruese në Parkun Kombëtar ‘Sharri’ në territorin e komunës së Suharekës, në bjeshkët e Dellocit.
- Në bashkëpunim me sektorin e GIS në AMMK është realizuar vizitë monitoruese në territorin e Parkun Kombëtar ‘Bjeshkët e Nemuna’, në komunën e Pejës.
- Realizimi i vizitës monitoruese në territorin e Monumentit të Natyrës me Rëndësi të Veçantë “Ujëvarat e Mirushës”, në territorin e komunës së Malishevës dhe Klinës.
- Në bashkëpunim me Institutin e Arkeologjisë të Kosovës është vizituar MNRV “Shpella e Gadimës”.
- Në bashkëpunim me klubin Alpin Prishtina dhe klubin Alpin Potguri është vizituar Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” konkretisht bjeshka e Kaliqanit.
- Realizimi i vizitës në terren në territorin e Masivit malor Bjeshkët e Nemuna, në zonën e Moknes dhe Jerebinës në territorin e komunës së Istogut dhe Zubin Potokut.
- Realizimi i vizitës në terren në komunën e Ferizajit në kuadër të monitorimit të gjendjes së vlerave natyrore në territorin e kësaj komune.
- Realizimi i vizitës monitoruese në terren, në territorin e Parkut të Natyrës “Mali Pashtrik dhe liqeni i Vërmicës” në territorin e komunës së Prizrenit me qëllim konstatimin e gjendjes.

2. Raportimi

Raportimi në EIONET dhe Bashkëpunimi me Agjencionin Evropian të Mjedisit.

Sa i përket bashkëpunimit me Agjencionin Evropian të Mjedisit-EEA dhe procesit të Raportimit në Rrjetin Evropian të Mjedisit-EEA dhe në Rrjetin Evropian të Sistemit të Informimit dhe Mbikëqyrjes-EIONET, edhe gjatë vitit 2024 ka vazhduar bashkëpunimi me këto institucione. Në kuadër të aktiviteteve dhe angazhimeve në procesin e raportimit për zonat e mbrojtura dhe biodiversitetin, IKMN ka vazhduar, ka raportuar me sukses në EIONET për indikatorin Common Database on Designated Areas (CDDA).

- Angazhim në përgatitjen për raportimit të indikatorit CDDA në Agjencinë Evropian të Mjedisit për zonat e mbrojtura gjatë vitit 2023.

3. Projektet

Gjatë vitit 2024, IKMN-ja ka qenë pjesë e disa projekteve shumë të rëndësishme në nivel kombëtar, ndërkombëtar dhe rajonal e ndër to vlen të veçohen:

- Projekti regional EUforGreen, për marrjen e përvojave në zbatimin e Agjendës së gjelbër në Ballkan;
- Projekti regional EUforGreen, për identifikimin e llojeve dhe habitateve në PK Bjeshkët e Nemuna, konkretisht tek lokacioni Zalli i Rupës, të PK “Bjeshkët e Nemuna”.

4. Ngritja e kapaciteteve

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve gjatë vitit 2024, zyrtarët e IKMN –së, kanë marrë pjesë në disa, trajnime, seminare, punëtori, konferenca dhe organizime tjera si:

- Pjesëmarrja në punëtorinë dy ditore për hartimin e strategjisë së mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, organizuar nga DMMU-ja në kuadër të projektit EU4Green.
- Pjesëmarrja në dy takime virtuale me përfaqësuesit e IUCN-së, ekspertët vendor dhe rajonal.
- Pjesëmarrja në takimin zyrtar me përfaqësuesit e Akademisë Evropiane të Mjedisit
- Pjesëmarrja në takimin zyrtar me ekspertët lokal dhe vendor të organizuar nga DMMU-ja dhe EEF-i.
- Pjesëmarrja në konferencën regjionale të organizuar nga fondacioni EURANATYRA nga Gjermania në bashkëpunim me Fondacionin për biodiversitetin nga Bullgari.
- Pjesëmarrja në punëtorinë me ekspertet ndërkombëtar në kuadër të projektit të NPRI (Nacional Peer Review Initiative) nga organizata IMPEL (European Union Network for the Implementation and Enforcement for Environment Laë).
- Pjesëmarrja në takimin virtual me ENCA.
- Pjesëmarrja në takimin virtual: “Monitorimi i biodiversitetit dhe zgjedhjet e bazuara në natyrë”, organizuar nga EU for Green .
- Përgatitja e raportit nga pjesëmarrja në konferencën regjionale të “Brezit të Gjelbër Evropian”, organizuar nga EURONAYRA dhe mbajtur në Haskovo, të Bullgarisë.
- Pjesëmarrja në punëtorinë lidhur me promovimin dhe fuqizimin e grave në zonat rurale në vendin tone, organizuar nga FAO.
- Përgatitja e raportit për gjashtëmujorin e parë të punës për monitorimin dhe hulumtimin e biodiversitetit, për vitin 2024.
- Me ftesën e EURONATYRES është realizuar takimi virtual me akterët (MBPZHR dhe OJQ-ne “ERA”) e projektit propozimit LIFE DinPin.
- Pjesëmarrja në vizitën studimore në Agjencinë e Mbrojtjes së Mjedisit, në Slloveni.
- Pjesëmarrja në takimin virtual me përfaqësuesit e zyrës së Bashkimit Evropian në vendin tone dhe ekspertët vendor dhe ndërkombëtar.

- Pjesëmarrja në takimin me Asamblenë Gjenerale me Biodiversa+, ne Bullgari.
- Me kërkesën e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), është mbajtur takim virtual ku janë bere prezantime të praktikave te mira ne lidhje me dekarbonizimin dhe ruajtjen e biodiversitetit.
- Pjesëmarrja në konferencën “Diskutimet për Natyra e Ballkanit”, të mbajtur në Vjenë
- Pjesëmarrja në konferencën Pan-Evropiane, organizuar nga Organizata “Brezi i Gjellbër Evropian”, mbajtur ne Letoni.
- Takim virtual me Federaten EUROPARC
- Pjesëmarrja në punëtorinë organizuar nga OJQ-ja EËEF, mbajtur te Pylli i arinjve, në të cilën përveç ekspertëve vendor kanë marrë pjesë edhe ekspertët ndërkombëtar, ku është diskutur në lidhje me menytrat me te mira te menaxhimit të gjitarëve.
- Pjesëmarrja në takimin virtual, me kërkesën e zyrës se BE-së, në Prishtinë
- Pjesëmarrja në takimin virtual, me kërkesën e ADA-se, zyra në Prishtinë.
- Pjesëmarrja në konferencën “Diskutimet për Natyrën e Ballkanit”, organizuar nga UNEP, mbajtur në Vjenë, të Austrisë.
- Pjesëmarrje në punëtorinë “Ndotja e lumit Ibër, praktikat e monitorimit dhe menaxhimit me theks të veçantë në faunën e peshqve”.
- Pjesëmarrje në takimin (online) Nationally designated areas datafloë Proposal for revising the reporting formate, i organizuar nga Agjencia Evropiane e Mjedisit.
- Pjesëmarrje në punëtorin e organizuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencia e Pyjeve të Kosovës, në bashkëpunim FAO, zyrën e BE në Kosovë dhe Ambasada e Suedisë në Prishtinë.
- Pjesëmarrja në trajnimin për zbatimin e ligjit, organizuar nga Agjensioni Evropian.
- Pjesëmarrje në vizitë studimore në Suedi.
- Pjesëmarrje në punëtorinë e organizuar nga CNVP (Connecting Natural Values and People).
- Pjesëmarrje në takimin virtual të organizuar në lidhje me vlerësimin e bashkëpunimit në mes AMMK-së dhe SëEPA-së .
- Pjesëmarrje në punëtorin “Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile Mjedisore në Kosovë.
- Pjesëmarrje në Simpoziumin “Monumentet e natyrës së Shqipërisë dhe vlerat e tyre natyrore, historike, kulturore, shpirtërore dhe turistike”. Simpoziumi është organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Universiteti Fan Noli Korçë.

5. Hartimi i Studimeve dhe Arsyeshmerive Profesionale

Gjatë vitit 2024, IKMN-ja ka përgatitur arsyeshmeritë profesionale për marrjen nën mbrojtje të disa vlerave te natyrës:

- Pjesëmarrja në takimin me grupin punues për hartimin e Arsyeshmërisë profesionale për Rrjedhën e lumit Mirusha.

- Pjesëmarrja në takimin me grupin punues për hartimin e Arsyeshmërisë profesionale për Burimin e Drinit të Bardhë dhe Shpellës së Radavcit.

6. Pjesëmarrja në Grupe Punuese, Komisione dhe Këshille Organizative

- Përgatitja e raportit nga punëtorja për menaxhimin e grumbullit, organizuar në Plave, Mali i Zi, nën mbështetje të SIDA-së.
- Përgatitja e kërkesës për anëtarësim në ENCA.
- Përgatitja e raportit të shkurtër për biodiversitetin pas realizimit të vizitës hulumtuese tek Burimi i ujit, afër Liqenit të Përlepnicsës në komunën e Gjilanit.
- Pjesëmarrja në manifestimin e Ditës Ndërkombëtare të Pyjeve, organizuar nga FAO, në bashkëpunim me MBPZHR-në dhe APK-në.
- Takim zyrtar në stafin e kabinetit nga komuna e Hanit të Elezit.
- Përgatitja e raportit të punës praktike për praktikanten e IKMN-së.
- Takim zyrtar me përfaqësuesit e TIKA-së.
- Përgatitja e raportit pas realizimit të vizitës monitoruese në peizazhin e mbrojtur “Gërmia”.
- Plotësimi i pyetësorit pas përfundimit të kursit me Akademinë Evropiane të Natyrës.
- Pjesëmarrja në aktivitetin e përbashkët për vendosjen e platformave për zogjët në komunën e Ranillugut, aktivitet ky që u realizua në bashkëpunim me komunitetin Ëildlife photographer, KEDSC dhe KESCO.
- Përgatitja e raportit të shkurtër për ëeb-in e AMMK-së, pas përfundimit të aktivitetit për vendosjen e platformave për zogjët folezues, në fshatin Ropotovë, të komunës së Ranillugut.
- Me kërkesën e FAO-së, janë dhënë komentet në draft dokumentin Menaxhimi i integruar i zjarreve.
- Janë dhënë komentet në draft dokumentin korniza analitike dhe udhërrëfyesit për zhvillimin e Planit Strategjik të Biodiversitetit në Ballkanin Perëndimor.
- Përgatitja e kërkesës për FAO-në, për mundësin e bashkëpunimit në projektet për konservimin e natyrës
- Pjesëmarrja në takimin zyrtar me ekspertet nga AMMK-ja dhe Agjensioni i Mjedisit të Suedisë.
- Plotësimi i dy pyetësorve pas përfundimit të dy konferencave me “Brezin e Gjellbër Evropian” të organizuar nga fondacioni EURONATYRA nga Gjermania.
- Përgatitja e raportit nga vizita monitoruese në terren përgjatë rrugës për të maja e zezë, në kuadër të parkut kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” në komunën e Pejës.
- Plotësimi i pyetësorit pas takimit virtual me ekspertet ndërkombëtar në kuadër të projektit EUforGreen.
- Përgatitja e raportit pas realizimit të vizitës në rezervatin strik “Gubavci” në komunën e Pejës.

- Plotësimi i pyetësorit pas përfundimit të konferencës së “Brezit të Gjelbër Evropian”, mbajtur në Haskovo të Bullgarisë.
- Përgatitja e raportit të shkurtër për ëeb-in e AMMK-së, pas njoftimit për lëndimin e Lejlekut të Bardhë (*Ciconia ciconia*), në rrethinën e komunës së Obiliqit.
- Me kërkesën e organizatës “Brezi i Gjelbër Evropian” nga Gjermania, është plotësuar pyetësori, në lidhje me rendësin e bashkëpunimit, si dhe pritjet nga ky bashkëpunim.
- Me kërkesën e Biodiversa+ është plotësuar pyetësori, në lidhje me rendësinë e bashkëpunimit në nivel evropian.
- Përgatitja e agjendës për takimin me ekspertet vendor dhe ndërkombëtar nën mbështetje të TAIEX-it.
- Përgatitja e raportit pas përfundimit të takimit në Slloveni.
- Me kërkesën e MBPZHR-se janë dhënë komentet në Draft Programin Zhvillimor për Menaxhim të kafshëve të egra.
- Përgatitja e raportit të shkurtër për biodiversitetin e Moknës, në anën veriore të vendit.
- Pjesëmarrja në manifestimin e "Ditës Botërore për mbrojtjen e Kafshëve".
- Përgatitja e raportit nga pjesëmarrja në takimin me Asamblenë gjeneralë të organizuar nga Biodiversa+, mbajtur në Sofje të Bullgarisë.
- Plotësimi i pyetësorit pas përfundimit të konferencës Pan-Evropiane, organizuar nga Organizata “Brezi i Gjelbër Evropian” nga Gjermania.
- Përgatitja e raportit për vlerat natyrore të Moknës dhe Liqenit të Ujmanit, për shpalljen e kësaj zone nën mbrojtje paraprake.
- Angazhimi rreth organizimit të punëtorisë me TAIEX dhe përgatitja e listës së pjesëmarrësve të cilat do të marrin pjesë në punëtorinë me temën: “Zonat e mbrojtura dhe identifikimi i zonave të Natyrës 2000” që do të organizohet nga Instituti i Natyrës nën përkrahje teknike të TAIEX-it.
- Përgatitja e dy raporteve pas vizitave monitoruese në terren në zonën e mbrojtur të zogjëve “Ligatina e Hencit”.
- Përgatitja e raportit mbi gjendjen e biodiveritetit për vitin 2024.
- Pjesëmarrja në takimin e organizuar nga IPH dhe nga MMPHI-ja me ekspertët e FSHMN-së, Departamenti i Biologjisë të Universitetit të Prishtinës.
- Pjesëmarrje në takimin e punës të organizuar me zyrtaret e Drejtorisë së Mjedisit të komunës së Obiliqit.
- Përgatitja e materialit për Ëeb faqen e AMMK-së në lidhje me procedimin për mbrojtje të vlerave natyrore në komunën e Prizrenit.
- Takim zyrtar me përfaqësuesit e Drejtorisë së Parqeve, Drejtorisë së Emergjencave dhe Drejtorisë së Punëve publike të komunës së Prishtinës në lidhje me gjendjen në Peizazhin e mbrojtur “Germia”.
- Angazhim në përgatitjen e materialit për zonën e propozuar për mbrojtje Shpella e Zymit “në territorin e komunës së Prizrenit.

- Plotësimi i pyetësorit pas përfundimit të kursit me Akademinë Evropiane të Natyrës
- Përgatitja e raportit nga pjesëmarrja në konferencën regjionale të “Brezit të Gjelbër Evropian”, organizuar nga EURONAYRA dhe mbajtur në Haskovo, të Bullgarisë.
- Përgatitja e raportit nga takimi në Vjenë, organizuar në UNEP.
- Përgatitja e raportit pas përfundimit të Konferencës Pan-Evropiane, në Letoni.
- Determinimi i materialit biologjik të MN të evidentuara në Hanin e Elezit.
- Përgatitja e materialit (raproti, elaboratet dhe vendimet) për MN të evidentuara në komunën e Hanit të Elezit.
- Përgatitja e raportit mbi gjendjen e biodiversitetit gjatë vitit 2024.
- Pjesëmarrje në jurinë profesionale për ndarjen e çmimit mjedisor për shkollën “Dervish Rozhaja”, i akorduar nga Caritasi Zvicëran dhe MZHR.
- Vlerësimi dhe ndarja e çmimeve në kuadër të projekti “Ndikimi i Rinisë në Mjedis” (YENI) i Caritasit Zvicëran me ko-financim nga Ministria e Zhvillimit Rajonal për shkollat e mesme dhe profesionale.
- Përgatitja e raportit nga vizita monitoruese të vlerave të trashëgimisë natyrore në Monumentin e Natyrës ‘Gryka e Rugovës’, në territorin e komunës së Pejës.
- Në bashkëpunim me institucionet vendore, universiteti, EEF, OJQ-të është realizuar vizitë në terren në MNRV “Ujëvarat e Mirushës”.
- Përgatitja e draftit të raportit nga vizita monitoruese në vlerat e trashëgimisë natyrore-Monumentin e Natyrës në territorin e komunës së Vushtrrisë.
- Përgatitja e raportit nga vizitë monitoruese në disa vlerat e trashëgimisë natyrore në komunën e Suharekës – zona potenciale për mbrojtje.
- Takim pune në komunën e Prizrenit-Drejtoria për Shërbime Publike dhe pjesëmarrja në punimet e kuvendit komunal të Prizrenit.
- Shqyrtimi i bazës numerike dhe hartografike të pronësisë në zonën: Guri i Hoxhës dhe burimi i ujit në komunën e Ranillugut si zonë potenciale për marrje nën mbrojtje.
- Takim pune në kuadër të implementimit të projektit për “Shenjëzimin dhe digjitalizimin e zonave të mbrojtura të natyrës”.
- Angazhim në kuadër të realizimit të projektit për “Shenjëzimi dhe digjitalizimi i zonave të mbrojtura të natyrës”.
- Përgatitja e draftit të raportit nga vizita monitoruese në Parkun Kombëtar ‘Bjeshkët e Nemuna’, në komunën e Deçanit respektivisht në Bjeshkët e Strelcit.
- Angazhim në përgatitjen e hartës në lidhje me ndërhyrjet në Parkun Kombëtar ‘Bjeshkët e Nemuna’, në Bjeshkët e Strelcit.
- Në bashkëpunim me profesorin e departamentit të biologjisë është bërë hulumtimi i florës në shpellat (Zatriq, Panorc, Radac, Dush).
- Angazhim në përgatitjen e takimit të parë të grupit punues për ri kategorizimin e monumentit të natyrës “Kanioni i Drinit të Bardhë”, në territorin e komunës së Rahovecit.

- Angazhim në grumbullimin e materialit të nevojshëm për grupin punues për ri kategorizimin e monumentit të natyrës “Kanioni i Drinit të Bardhë”, në territorin e komunës së Gjakovës dhe Rahovecit.
- Angazhim në kuadër të grupin punues në përgatitjen e draftit të arsishmëris profesionale për ri kategorizimin e monumentit të natyrës “Kanioni i Drinit të Bardhë”, në territorin e komunës së Gjakovës dhe Rahovecit.
- Në kuadër të grupit punues për ri kategorizimin e monumentit të natyrës “Kanioni i Drinit të Bardhë”, është përgatitur drafti i arsishmëris profesionale për ri kategorizimin e monumentit të natyrës “Kanioni i Drinit të Bardhë”, i cili është përcjell për komente dhe plotësime te anëtarët tjerë të grupit punues .
- Është përgatitur raporti nga komisioni pranues në kuadër të realizimit e projektit për “Shenjëzimi dhe digjitalizimi i zonave të mbrojtura të natyrës”, pas përfundimit të projektit.
- Angazhim në grumbullimin e materialit të nevojshëm për grupin punues për hartimin e arsishmëris profesionale për Monumentin e natyrës “Rrjedha e lumit Mirusha” dhe harmonizimin e vendimit me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës
- Angazhim në përgatitjen e draftit të raportit për aktivitetet e realizuar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024 në IKMN.
- Përgatitja e raportit nga dy vizitat monitorues në Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” respektivisht të rezervatit strikt “Bjeshka e Kozhnjerit me Majën e Ropsit”, në territorin e komunës së Deçanit.
- Angazhim në lidhje me përgatitjen e hartës nga ndërhyrjet e konstatuara gjatë vizitës monitoruese në Rezervatin strikt “Bjeshka e Kozhnjerit dhe Maja e Ropsit”.
- Takim pune me zyrtarët nga Instituti për Planifikim Hapësinorë me qëllim të kordinimit të aktiviteteve.
- Angazhim në kuadër të grupit punues për përgatitjen e Planit Menaxhues të Parkut Kombëtar ‘Sharri’.
- Përgatitja e raporti nga vizita monitoruese në territorin e Monumentit të Natyrës me Rëndësi të Veçantë “Ujëvarat e Mirushës”.
- Angazhim në përgatitjen e materialit (tabelës) në lidhje me gjendjen e zonave të mbrojtura gjatë vitit 2023.
- Angazhim në përgatitjen e përgjigjes për komunën e Podujevës në lidhje me statutin e zonës së mbrojtur trugu i plepit në Bajqinë.
- Kontakt me Drejtorin e Drejtorisë së urbanizmit dhe mjedisit në komunën e Rahovecit .
- Përpunimi i te dhënave për zonat e mbrojtura (monumentet e natyrës).
- Angazhim në përgatitjen e materialit në lidhje me gjendjen e zonave të mbrojtura gjatë vitit 2023 sipas kërkesës së Drejtorisë për raportim në AKMM-së .
- Përgatitja e draft materialit hartografik në kuadër të shqyrtimit të mundësive për zgjerimin e sipërfaqes së Parkut Kombëtar “bjeshkët e Nemuna” në Malin Mokna.

- Angazhim në shqyrtimin materialit të nevojshëm për grupin punues për hartimi e arsyshmëris profesionale për Monumentin e natyrës “Rrjedha e lumit Mirusha” dhe harmonizimin e vendimit me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës .
- Angazhim në kuadër të grupit punues për përgatitjen e propozim profesional për ri kategorizimin e Monumentit të Natyrës “Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë”.
- Angazhim në kuadër të iniciativës për marrjen nën mbrojtje te vlerave natyrore të masivit malor në zonën e Moknes dhe Jerebinës në territorin e komunës së Istogut dhe Zubin Potokut .
- Kontakt me zyrtarët komunal të komunës së Prizrenit dhe Gjakovës me qëllim të koordinimit të aktiviteteve.
- Përgatitja e kontributit/inputit të parë për Raportin e KE-së për Kosovën – 2024
- Pritje në IKMN studentët e drejtimit Biologji dhe Ekologji nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.
- Takim me kryetarin e Komunës se Pejës z. Muhaxheri.
- Takim pune me zyrtarët nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis të komunës së Prishtinës me qëllim të koordinimit të aktiviteteve.
- Përgatitja e kontributit/inputit të dytë për Raportin e KE-së për Kosovën – 2024, pjesa që ndërlidhet me IKMN.
- Takim me përfaqësuesin e zyrës së BE-së ne Kosove z. Olivier Boudard.
- Përgatitja e raportit të performancës të institucionit IKMN/AMMK.
- Angazhim në përgatitjen e përgjigjes për OJQ GAIA Kosova, në lidhje me informatën e pranuar nga kjo OJQ.
- Eshtë plotësuar pytësori për vlersimin e cenushmerisë nga ndryshimet klimatike në Kosovë, që nderlidhet me pjesën e natyrës.
- Takim me Merita Fehmiu menaxhere e programit Peace Corps / Kosovo.
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Korpusi i Paqes ne Kosove- Peace Corps /Kosova.
- Pjesëmarrje në përgatitjen e testeve dhe organizimin e testeve me shkrim për tri pozita e vendeve të punës.

7. Dhënia e mendimeve profesionale dhe përgjigjeve për çështje të ndërlidhura më zonat e mbrojtura dhe biodiversitet

- Përgatitja e përgjigjes për QTKP dhe shoqërin civile në lidhje me menaxhimin e llojti invaziv që gjendet në disa pjesë të qytetit të Prishtinës.
- Përgatitja e përgjigjes për Fondacionin Pylli i arinjeve Prishtina, në lidhje me lloj të miut, i cili është paraqitur në këtë zonë.
- Përgatitja e përgjigjes dhe e materialit, bazuar në kërkesën e zyrtarëve të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Komuna Vushtrr.

- Përgatitja e përgjigjes për Departamentin e Integriteteve në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

8. Bashkëpunimi me institucionet tjera

Puna dhe aktivitetet e IKMN-së janë ngusht të lidhura nga bashkëpunimi me institucionet tjera relevante qendrore dhe lokale, shkencore hulumtuese, vendore dhe ndërkombëtare. Në kuadër të këtij angazhimi janë realizuar aktivitete të ndryshme bashkëpunimi me:

- Ministrinë dhe agjencitë relevante vendore dhe ndërkombëtare, si dhe komunat;
- Institucionet ndërkombëtare si me: EURONATURE, SIDA, IUCN, ËËF, FOUR PAËS, ENCA, Biodiversa+, UNEP, Rrjeti i pyejeve të ahut të vjetër evropian, Kopusi i Paqës, etj;
- Universitetin e Prishtinës, Departamentin e Biologjisë dhe Gjeografisë;
- Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë;
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë;
- Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Departamenti i Gjeografisë;
- Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës – ASHAK;
- Bashkëpunimi me Institutin për Hulumtime Karstike të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Sllovenisë;
- Bashkëpunimi me Shoqatën Speleologjike nga Bullgaria;
- OJQ mjedisore, në shënimin e ngjarjeve mjedisore me qëllim të ngritjes së vetëdijes së publikut për mbrojtjen e mjedisit.

9. Ngecjet

Gjatë realizimit të planit të punës dhe aktiviteteve për vitin 2024, IKMN-ja ka hasur edhe në shumë ngecje dhe probleme ndër të cilat veçohen:

- Mungesa e stafit;
- Mungesa e pajisjeve për punë (veturës adekuate për terren, kamera dixhitale, rroba për terren. GPS etj.);
- Mungesa e fondeve për hulumtimin e vlerave të natyrës dhe biodiversitetit;
- Mungesa e trajnimeve profesionale;
- Mungesa e lokalit,
- Etj.

4. Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtarë “Sharri”

1. Objektivat dhe aktivitetet kryesore në PK “Sharri” për vitin 2024

Gjatë vitit 2024, Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar (DAPK) “Sharri” ka realizuar aktivitete dhe detyra të përcaktuara sipas planit të punës dhe dokumenteve tjera relevante. Aktivitetet dhe veprimet kryesore kanë qenë të fokusuara kryesisht në mbrojtjen e vlerave natyrore dhe përmirësimin e gjendjes së këtyre vlerave pasi që vazhdimisht rrezikohen nga ndikimet negative të faktorëve biotik (njeriu, insektet dëmtues dhe fitopatogjenet) dhe abiotik (fatkeqësitë natyrore, zjarret etj.).

Objektivat kryesore të DAPK “Sharri” që janë realizuar në vitin 2024 kanë qenë:

- 1) Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale;
- 2) Mbrojtja e pyjeve nga zjarret, insektet dëmtuese dhe sëmundjet;
- 3) Monitorimi dhe mbrojtja e florës dhe ekosistemeve;
- 4) Monitorimi dhe mbrojtja e faunës (kafshëve të egra);
- 5) Monitorimi, mbrojtja dhe hulumtimi i gjendjes së rezervateve strikte të natyrës ;
- 6) Monitorimi i zonave turistike dhe ndërtimeve;
- 7) Shfrytëzimi i qëndrueshëm dhe racional i resurseve natyrore;
- 8) Monitorimi i pronave në pronësi private;
- 9) Promovimi i PK Sharri, informimi dhe vetëdijësimi i publikut për mbrojtjen e mjedisit;
- 10) Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare;
- 11) Kompletimi i infrastrukturës ligjore dhe planifikuese të PK “Sharri”;
- 12) Përmirësimi i kushteve të punës për punonjësit e DAPK “Sharri”.

Në vijim janë paraqitur objektivat dhe aktivitetet kryesore që janë realizuar në vitin 2024:

2. Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale

- Hartimi dhe dorëzimi në AMMK/MMPHI i Planit për mbrojtjen, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pyjeve për vitin 2024.
- Hartimi i Planit vjetor për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale në Parkun Kombëtar “Sharri”.
- Angazhimi i vazhdueshëm i ekipeve dhe rojtarëve në terren edhe jashtë orarit të punës (natën, uikendit dhe festave). AMMK ka aplikuar pagesat shtesë për angazhimin e punëtorëve jashtë orarit të punës në bazë të kërkesave DAPK “Shari”.
- Ndërmarrja e masave ligjore kundër vjedhësve të pyjeve. Janë plotësuar dhe dorëzuar në organet e drejtësisë (Prokurori dhe Gjykatë) 65 fletëpadi për vjedhjen e pyjeve për masën drunore 416.05 m³ në vlerë të dëmit pyjor prej 124,815.00 Euro (300.00 €/m³). Problemin e vazhdueshëm e paraqesin prerjet ilegale të pyjeve, në veçanti në malin Luboten që shtrihet në komunat e Kaçanikut dhe Shtërpçës. Gjatë këtij viti në PK “Sharri” janë regjistruar dëmet pyjore nga prerjet ilegale në sasi prej 5,850.00 m³ (Prizren – 34.50 m³, Suharekë - 45.37 m³, Dragash – 14.01 m³, Shtërpçë - 1605.33, Kaçanik – 3.733.81 m³). Dëmet pyjore nga prerjet ilegale të pyjeve sipas rajoneve menaxhuese janë paraqitur në vijim: Strazhë/Gllboçicë – 1,541.77 m³; Dubravë 1,126.64 m³, Sllatinë/Jasik – 1,066.24 m³, Sevcë – 4.55 m³, Berevcë - 46.77 m³, Vërbeshticë - 2.53 m³, Brezovicë - 7.33 m³, Shtërpçë - 42.04 m³, Gotovush – 3.99 m³, Firajë -

910.14 m³, Brod – 593.98 m³, Rapçë/Krstec – 2.15 m³, Gllloboçicë/Krushevë - 11,86 m³, Zhur/Brezne/Buqe – 31,88 m³; Mushtisht/Delloc – 45.37 m³, Kabash/Grekoc – 2.05 m³; Ljubinje – 1,07 m³. Nga prerjet ilegale më të rrezikuara janë pyjet e ahut në rajonet menaxhuese Strazhë-Gllloboçicë, Dubravë dhe Sllatinë/Jasik (komuna e Kaçanikut) si dhe rajonet Brod, Firajë, Berevcë dhe Vërbeshticë (komuna e Shtërpcës), ndërsa shkaqet kryesore janë: mungesa e rojtarëve të natyrës, ekzistimi i grupeve të organizuara të vjedhësve të pyjeve; mosrealizimi i fletëpadive në Gjykatat përkatëse; mosaprovimi dhe moszbatimi i Planit për prerjet dhe pastrimet sanitare dhe furnizimin e komunitetit lokal me dru zjarri, pasiguria e punëtorëve në terren, posaçërisht gjatë natës dhe gjendja e vështirë socio-ekonomike e popullatës rurale.

- Konfiskimi në bashkëpunim me Policinë dhe Prokurorinë: 59.03 m³ druve ilegale dhe 15 mjete transportuese (2 traktor “Rakovica” me rimorkio, 2 “xhipa”, 5 kombi, 2 “pikap”, 2 automjete “Golf” dhe “Askona”, 2 qere të kuajve) me të cilët është kryer vjedhja e pyjeve në PK “Sharri”. Nga mbikëqyrësit janë plotësuar 24 Procesverbale për konfiskimin e druve ilegale dhe 19 Procesverbale për konfiskimin e mjeteve transportuese që janë përdorur për vjedhjen e pyjeve në PK “Sharri”.
- Punësimi i një praktikanti/juristi dhe 11 praktikantëve/rojtareve të natyrës në muajin gusht (pas 6 muaj të mungesës së tyre në terren) me kontrata të përkohshme (1 rojtar në Dragash, 3 rojtar në Kaçanik dhe 7 rojtar në Shtërpcë) nga AMMK/MMPH. Në komunën e Shtërpcës për shkak të mosangazhimit të duhur në terren dhe mungesës së rezultateve të punës është ndërprerë kontrata e një rojtarit të natyrës, ndërsa një rojtar ka dhënë dorëheqje.
- Prishja/Mbyllja e rrugëve alternative pyjore në 33 lokacione në malin Luboten (komunat e Kaçanikut dhe Shtërpcës) për ndalimin e lëvizjes së mjeteve transportuese në brendësi të pyjeve të PK “Sharri” me qëllim të parandalimit të vjedhjes së pyjeve në bazë të Projektit (kërkesës) së DAPK “Sharri” për ndalimin e prerjeve ilegale të pyjeve në PK “Sharri” që është aprovuar nga AMMK/MMPH.
- Pjesëmarrje në seancat gjyqësore për vjedhjen e pyjeve në PK “Sharri”.
- Analiza e Aktvenimeve të Gjykatave dhe përgatitja e ankesave për Gjykatën e Apelit.
- Realizimi i kontrollave dhe intervenimeve në terren në vazhdimësi për parandalimin e prerjeve ilegale të pyjeve.
- Kujdestaria në terren (angazhimi i rojtarëve dhe ekipeve mbikëqyrëse) gjatë ditëve të vikendit dhe festave shtetërore.
- Bashkëpunimi me komunat, pylltarinë, policinë, prokurorinë, inspekcionet, bashkësitë lokale për parandalimin e prerjeve ilegale të pyjeve;
- Sensibilizimi dhe vetëdijësimi ekologjik i vizitorëve dhe komunitetit lokal të zonave të rrezikuara nga vjedhja e pyllit.

3. Mbrojtja e pyjeve nga zjarret, insektet dëmtues dhe sëmundjet

- Huluntimi i pyjeve për identifikimin e shkaktarëve të sëmundjeve bimore dhe insekteve dëmtuese;
- Hartimi i Planit vjetor për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret në Parkun Kombëtar “Sharri”

- Vëzhgimi i zonave të rrezikuara nga zjarret gjatë verës;
- Bashkëpunimi me zjarrfikësit, policinë dhe bashkësitë lokale në parandalimin e zjarreve;
- Pjesëmarrje në seminarët për shuarjen e zjarreve të organizuara nga FAO dhe OSBE;
- Intervenimi i DAPK “Sharri”, në bashkëpunim në Brigadën e zjarrfikësve, FSK-në, Policinë, Drejtorinë e Emergjencave të komunës së Prizrenit dhe vullnetarët me motor-krosa, në shuarjen e zjarrit në rezervatin e natyrës “Maja e Arnenit” i mbuluar me pyjet e rrobullit (*Pinus heldreichii*), rajoni menaxhues Prevala që është paraqitur me datën 05.08.2024. dhe është shuar plotësisht me datën 25.08.2024. pas reshjeve të dendura të shiut. Kontribut të jashtëzakonshëm ka dhënë edhe KFOR-i që me datat 14. dhe 17.08.2024. ka angazhuar dy helikopter për lokalizimin e zjarrit pasi që është rrezikuar fshati turistik Pevalla.

Me qëllim të parandalimit të zgjerimit dhe deportimit të zjarrit në fshatin turistik Prevala, mbi këtë fshatë me datat 13. dhe 14.08.2024. është hapur brezi ndarës në gjatësi rreth 500 m dhe gjerësi prej 4 metra me eskavator i cili është angazhuar nga Drejtoria e Emergjencave të Prizrenit në bazë të konsultave me Shtabin e Emergjencës i përbërë nga udhëheqësit e këtyre institucioneve: Drejtoria e Emergjencave Prizren, Policia, Brigada e Zjarrfikësve dhe DAPK “Sharri”.

Dyshohet se zjarri është ndezur qëllimisht nga njerëz të ligë dhe dashakeq të paignifikuar.

- Huluntimi i dëmëve të shkaktuara nga zjarri në rezervatin e natyrës “Maja e Arnenit” Nga huluntimet e kryera në terren është konstatuar se zjarri ka qenë kryesisht sipërfaqësor, ndërsa sipërfaqja e përgjithshme e djegur e rezervatit natyror “Maja e Arnenit” është rreth 100 ha në kuadër të cilës janë djegur:

- pyjet e rrobullit (*Pinus heldreichii*) në sipërfaqe prej 70 ha, kryesisht janë dëmtuar pjesët e poshtme të trungjeve (qafa e rrënjës dhe livorja e trungjeve në lartësi nga 0.5 m deri 4 m), fidanët e rrobullit dhe ahut me vjetërsi të ndryshme, shkurret dhe barojat, ndërsa tërësisht janë djegur kurroret e druve të rrobullit në sipërfaqe rreth 1 ha mbi fshatin turistik dhe në pjesën qëndrore dhe perednimore të rezervatit natyror. Shumica e kurrove të druve të pihës - rrobullit nuk janë prekur nga zjarri por janë dëmtuar nga temperaturat e larta që janë krijuar nga flakët e zjarra.

- vegjetacioni shkurror i shelgut të egër (*Salix caprea*) në sipërfaqe 7 ha, dhe

- vegjetacioni barishtor-kullosat malore që shtrihen kryesisht mbi pyjet e rrobullit në sipërfaqe prej 23 ha.

Duke marrë parasysh se zjarri ka qenë sipërfaqësor ku kryesisht janë dëmtuar pjesët e poshtme të trungjeve (qafa e rrënjës dhe livorja deri në 4 m lartësi) nuk mund të përcaktohen dëmet pyjore nga zjarri në pyjet e rrobullit. Pasojat e vërteta negative të zjarrit do të dalin në dritë, respektivisht do të kuptohen gjatë periudhës 3 vjeqare kur varësisht nga intensiteti i dëmtimeve të trungjeve nga zjarri do të ketë edhe tharje të një pjese të caktuar të druve, respektivisht pyjeve të rrobullit.

- Furnizimi i DAPK “Sharri” me pajisje kundër zjarreve nga OSBE e cila ka dhënë si donacion këto pajisje: agregati me pompën e ujit për shuarjen e zjarrit në zonat malore, 10 aparate për shuarjen e zjarreve me kapacitet 25 litër, 10 uniforma dhe këpucë kundër zjarreve, 2 GPS etj.

Me këto pajisje është rritur dukshëm aftësia e DAPK “Sharrit” për intervenime në shuarjen e zjarreve në zonat malore.

4. Monitorimi dhe mbrojtja e florës (endemike, mjekuëse etj.) dhe ekosistemeve

- Hartimi i Projektit për mjetet e punës për komunikim, monitorim dhe hulumtim në Parkun Kombëtar “Sharri”;
- Realizimi i kontrollave në terren për parandalimin e mbledhjes së bimëve mjekuëse;
- Kontrollat e blegtorëve dhe kullosave të maleve të larta;
- Hulumtimi i llojeve endemike të florës dhe bashkësive të tyre;
- Mirëmbajtja e databazës për florën dhe ekosistemet;
- Raportimi dhe rekomandimi i masave për mbrojtjen dhe zhvillimin e resurseve natyrore
- Organizimi i takimeve dhe bashkëpunimi me policinë, komunitetin lokal dhe blegtorët për parandalimin e mbledhjes së bimëve mjekuëse dhe frutave pyjore në territorin e PK “Sharri”.

5. Monitorimi dhe mbrojtja e faunës (kafshëve të egra)

- Hartimi i Planit vjetor për mbrojtjen dhe zhvillimin e kafshëve të egra dhe shpendëve në Parkun Kombëtar “Sharri”
- Vëzhgimi i gjendjes së kafshëve të egra;
- Realizimi i kontrollave për parandalimin e gjuetisë ilegale në zonat më të rrezikuara: Bredhiku, Koritniku, Oshlaku, Koxha Ballkani, Rusenica dhe Guri i Zi.
- Vendosja e kamerave kurth në zonat e ndryshme natyrore (Oshlak, Gryka e Lumbardhit, Koxha Ballkan, Pashallare, Koritnik) dhe plotësimi i databazës për faunën e Parkut Kombëtar. Nga kamerat kurth dhe hulumtimet e kryera në zonat e lartcekura është konstatuar prania e shumëllojshme e gjitarëve: reqebulli, ariu i murrmë, maca e egër, ujku, dhelpira, kaprolli, dhija e egër, derri i egër, shqarthe i bardhë, shqarthe i artë, lepuri, ketri, vjedulla, gjeri i lajthijave etj. Gjendja e kafshëve të egra është e mirë, në veçanti vërehet zhvillimi i madh i ariut të murrmë.
- Pjesëmarrje në Seminarin e organizuar nga GIZ dhe Univerziteti i Konstancës nga Gjermania për metodat e identifikimit të llojeve të faunës dhe numrit të tyre në habitatet natyrore.
- Takimet informuese dhe vetdijesuese me Shoqatat e gjahtarëve në komunat ku shtrihet territori i PK “Sharri: Prizren, Dragash, Suharekë, Shtërpcë dhe Kaçanik.
- Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi me policinë dhe Shoqatat e gjahtarëve në parandalimin e gjuetisë ilegale.

6. Mbrojtja, monitorimi dhe hulumtimi i gjendjes së zonave strikte të natyrës

- Hartimi i Planit vjetor për mbrojtjen dhe monitorimin e zonave strikte të natyrës në Parkun Kombëtar “Sharri”;
- Organizimi i kontrollave dhe intervenimeve me qëllim të parandalimit të aktiviteve ilegale në zonat strikte: prerjeve të pyjeve, gjuetisë, ndërtimeve etj.
- Vëzhgimi i gjendjes së vlerave natyrore në zonat strikte;

- Hulumtimi dhe mbledhja e shënimeve për vlerat natyrore në zonat strikte të natyrës dhe mirëmbajtja e databazës;
- Analiza e gjendjes së rezervateve strikte të natyrës dhe propozimi i masave mbrojtëse.

7. Monitorimi i zonave turistike dhe ndërtimeve

- Hartimi i Projektit për masat për përmirësimin e shërbimeve dhe kushteve infrastrukturore në Qendrën turistike Brezovica;
- Vëzhgimi i aktiviteteve turistike-rekreative në vendet turistike;
- Organizimi i kontrollave dhe inspektimeve për parandalimin e ndërtimeve ilegale.
- Plotësimi i 44 Procesverbaleve për ndërtime ilegale (objekteve, rrugëve, çështjeve etj.) dhe procedimi i 29 kallëzimeve penale dhe 5 fletëpadi kundërvajtëse për ndërtime ilegale në organet e drejtësisë;
- Konfiskimi, në bashkëpunim me Policinë dhe Prokurorinë, i mjeteve me të cilët janë kryer punimet ilegale ndërtimore dhe dëgradimi i mjedisit në zonën e Prevallës: një mini eskavator Volvo, eskavator Libherr 900 dhe kamioni me tre akse Man.
- Bashkëpunimi me Policinë, Inspektionet e MMPHI-së dhe komunale për parandalimin e ndërtimeve ilegale;
- Mbikëqyrja e pastrimit të mbeturinave nga operatorët në zonat e Prevallës dhe Brezovicës;
- Raportimi për ndërtimet dhe rekomandimi i masave për parandalimin e ndërtimeve ilegale në PK “Sharri”;
- Vendosja e laurave ndaluese në zonën turistike Prevalla me qëllim të ndalimit të lëvizjes së automjeteve në brendësi të pyjeve;
- Rregullimi dhe digjitalizimi i laurës hyrëse në Ski Qendrën Brezovica në bazë të Projektit të financuar nga MMPHI;
- Shqyrtimi i kërkesave dhe përgatitja e përgjigjeve profesionale për kërkesat që ndërlidhën me ushtrimin e veprimtarive të ndryshme rekreative dhe ekonomike në zonat turistike të PK “Sharri”.
- Funksionimi i laurës dhe aplikimi i pagesave hyrëse për vizitorët në Qendrën turistike Brezovica gjatë sezonës dimërore, janar-mars.

8. Shfrytëzimi i qëndrueshëm dhe racional i resurseve natyrore

- Hartimi i Planeve vjetore për:
 - mbrojtjen, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pyjeve në PK “Sharri”;
 - mbrojtjen, ruajtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të kullosave malore në Parkun Kombëtar “Sharri”;
 - mbrojtjen dhe monitorimin e resurseve ujore në Parkun Kombëtar “Sharri”;
 - mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të produkteve pyjore jodrunore në Parkun Kombëtar “Sharri”

- Këtë vit Plani vjetor për mbrojtjen, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pyjeve në PK “Sharri” është zbatuar pjesërisht. Janë aplikuar masat sanitare dhe frunizimi i popullatës lokale vetëm nga pyjet private që paraqet rreth 20 % të planit, ndërsa tërësisht ka mbetur i perealizuar Plani për pyjet publike. Prerjet sanitare në pyjet private janë ndërmarr në bashkëpunim me APK-në në territorin e PK “Sharri” që shtrihet në komunat e Shtërpcës dhe Suharekës ku është paraqitur numri më i madh i kërkesave nga pronarët e pyjeve. Githsej këtë vit në PK “Sharri”, respektivisht në dy komunat e lartcekura janë realizuar: 133 kërkesa, 927.48 m³ të masës drunore/dru zjarri dhe 1,854.96 Euro të mjeteve financiare nga taksat (në komunën e Shtërpcës janë realizuar: 112 kërkesa, 677.48 m³ të masës drunore/dru zjarri dhe 1,354.96 Euro; në komunën e Suharekës janë realizuar: 21 kërkesa, 250 m³ masës drunore/dru zjarri dhe 500 Euro). Për kryerjen e punimeve pyjore profesionale (damkosja, transporti i druve, pagesat) është përdorur dokumentacioni zyrtar i APK-së. Mjetet financiare nga taksat në pyjet private janë destinuar në buxhetin e APK-së, ashtu që këtë vit nuk është bërë asnjë realizim financiar nga Plani i pyjeve në buxhetin e DAPK “Sharri”/AMMK. Është e palogjikëshme dhe e papranueshme që DAPK “Sharri”/AMMK të shpenzoje mund, energji, kohë dhe buxhet në mbrojtjen dhe menaxhimin e parqeve kombëtare, ndërsa mjetet financiare që realizohen në parqet kombëtare të derdhën në buxhetin e APK-së. Kjo praktik diskriminuese dhe shkatërruese ndaj parqeve kombëtare duhet të ndalohet dhe të ndërpritet kompetencat e APK-së në Parqet Kombëtare që ja ka mundur Ligji i ri i pyjeve i aprovuar në vitin 2023.
- Shfrytëzimi tradicional i kullosave të maleve të larta gjatë sezonës verore (maj-gusht) nga blegtorët dhe aplikimi i taksave për shfrytëzimin e kullosave. Në vitin 2024 janë paraqitur 32 kërkesa, ndërsa janë dhënë 27 kontrata (leje) blegtorëve për shfrytëzimin e kullosave në PK “Sharri” për 7547 bagëti (6640 dele, 780 qëngja, 88 lopë, 25 viça dhe 14 kuaj). Nga taksat për shfrytëzimin e kullosave janë realizuar 7,547.00 €. Vlera e taksave në bazë të Vendimit të MMPHI nr. 2612/22 të dt. 12.05.2022. ka qenë: 0.50 € për dele, 0.20 € për qëngja, 1.00 € për viça dhe 2.00 € për gjedha dhe kuaj.
- Funksionimi i laurës dhe aplikimi i pagesave hyrëse për vizitorët në Qendrën turistike Brezovica gjatë sezonës dimërore, janar-mars. Nga shitja e biletave hyrëse janë realizuar mjetet financiare në vlerë prej 43,513.00 €, të cilët janë dorëzuar në gjyrollogarinë e MMPHI-së/AMMK-së nr. 1000400070002120. Biletat që janë aplikuar kanë qenë në vlerë prej 0.50 € për deri 10 € (0.50 € për personat nën 18 vjeç, 1.00 € për personat e rritur, 2.00 € për automjete, 5.00 € për kombi bus dhe 10 € për autobus).
- Kontrollat dhe mbikëqyrja e vazhdueshme e shfrytëzimit të resurseve natyrore të PK “Sharri”.

9. Monitorimi i pronave në pronësi private

- Pranimi dhe analiza e kërkesave për shfrytëzimin e pronave private – pyjeve;
- Mbikëqyrja e gjendjes së pyjeve private;
- Dhënia e këshillave profesionale për mbrojtjen e pyjeve për pronarët;
- Mbajtja e databazës për gjendjen e resurseve natyrore në pronësi private.

10. Promovimi i PK “Sharri”, informimi dhe vetëdijesimi i publikut për mbrojtjen e mjedisit

- Pjesëmarrja në takimet dhe seminarët mjedisore në nivel lokal dhe ndërkombëtar, ndërsa më të rëndësishme janë organizuar nga:
 - SëEPA– promovimi i vlerave natyrore dhe turistike të PK “Sharri” në opinionin vendor dhe hartimi i Planit menaxhues të PK Sharri për periudhën 2025-2034;
 - OSBE - seminar për rreziqët dhe masat kundër zjarreve në natyrë;
 - EëF&FINCH – Seminar “Rritja e ndërgjegjësimit për zonat e mbrojtura ne rajonin e Sharrit”;
 - Qeveria e Zvicrës, MBPZHR dhe FAO – Mbrojtja e natyrës nga zjarret dhe Menaxhimi i zjarreve pyjore;
 - PK Mali Sharri dhe komuna Tearce (Maqedonia e Veriut)– Takimet për bashkëpunim dhe partneritet për konkurrim të përbashkët në Projektet mjedisore ndërkufitare të financuara nga fondet IPA-së;
 - Global Conservation - Takimet për Projektet për mbrojtjen e kafshëve të egra në PK Sharri;
 - GIZ – takimet dhe aktivitetet për zbatimin e Projektit High Scardus Trail që përfshin zonat e mbrojtura ndërkufitare të 3 shteteve Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut: PK Sharri, PK Mali Sharr, PK Mavrovo, PK Galiçica dhe Parku i Natyrës Korab-Koritnik;
- Organizimi i takimeve vetdisuese për mbrojtjen e natyrës me vizitorët në zonat turistike: Prevallë, Brezovcë, Koxha Ballkan dhe Gradanc;
- Shënimi i ngjarjeve mjedisore ndërkombëtare (Dita e Tokës, Dita e Mjedisit, Dita e Maleve) me program sensibilizimi dhe vetdijesimi si dhe promovimi i vlerave të PK Sharri;
- Organizimi i orëve ekologjike në shkollat fillore në fshatrat lokale në komunat e Prizrenit dhe Dragashit.

11. Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare

- Bashkëpunimi me institucionet qeveritare të Kosovës (komunat, policinë, gjykatat komunale, inspektoratet, APK etj.
- Bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare (KFOR, BE, UNDP, FAO, GIZ, SëEPA, EëF, OSBE etj.);
- Bashkëpunimi me institucionet kërkimore shkencore (Fakultetet, Kolegjet, Institutet);
- Bashkëpunimi me OJQ mjedisore (Shoqatat për ekologji, bjeshkatari, vëzhgim, gjueti, etj.)
- Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave të punës me PK Mali Sharr dhe PK Mavrovo nga Maqedonia e Veriut.

12. Kompletimi i infrastrukturës ligjore dhe planifikuese të PK “Sharri”

- Pjesëmarrja në komisionet për plotësimin e legjislacionit të MMPHI-së;

- Analiza e Planit Hapësinor të PK “Sharri” dhe pjesëmarrja në punëtorit të organizuara nga IPH-për hartimin e Planit të ri hapësinor;
- Analiza e Planit Menaxhues të PK “Sharri” dhe pjesëmarrja në punëtorit të organizuara nga SëEPA për hartimin e Planit të ri menaxhues;
- Hartimi i Planeve dhe Raporteve vjetore të punës, Projekteve dhe Planeve operative për mbrojtjen e vlerave natyrore të PK “Sharri”.

13. Përmirësimi i kushteve të punës për punonjësit e DAPK “Sharri”

- Aplikimi i shtesave për rojtarët e natyrës për punën jashtë orarit të punës;
- Furnizimi i rojtarëve të natyrës me uniforma zyrtare dhe këpucë terreni;
- Kontraktimi kompanisë për vendosjen (parkimin) e automjeteve të konfiskaura nga veprimet ilegale (prerejt, ndërtime etj.).

14. Propozimet dhe rekomandimet për sigurimin e menaxhimit të qëndrueshëm të PK “Sharri”

Për të përmirësuar gjendjen dhe siguruar menaxhimin e qëndrueshëm të PK “Sharri” duhet të ndërmerren masat e ndryshme, ndër të cilët veçohen:

Punësimi i punëtorëve dhe funksionalizimi i njësive/zyrëve lokale në komunat Dragash, Shtërpçë dhe Kaçanik në përputhje me Planin menaxhues të PK “Sharri” (2015). Si prioritet nevojitet punësimi i 17 punëtorëve të përhershëm në 3 komunat:

- 3 përgjegjës zyrtar - nga 1 përgjegjës/zyrtar pyjor në komunat Dragash, Shtërpçë dhe Kaçanik;
- 13 rojtar të natyrës (3 rojtar në Dragash, 7 rojtar në Shtërpçë dhe 3 në Kaçanik);
- 1 zyrtar për çështje juridike.

Punësimi i 17 punëtorëve të paraqitur paraqet minimumin e nevojshëm për të siguruar mbrojtjen adekuate dhe menaxhimin e qëndrueshëm të PK “Sharri”.

- **Përcaktimi i buxhetit vjetor për menaxhimin e qëndrueshëm** (mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe zhvillimin) të PK “Sharri”.
- **Shënjestimi i kufirit të brendshëm të PK “Sharri”** (zonave strikte të natyrës dhe zonave të treta për zhvillimin e turizmit).
- **Realizimi i fletëpadive për vjedhjen e pyjeve në PK “Sharri”** në Gjykatat përkatëse. Për këtë çështje nevojitet punësimi i juristit në DAPK “Sharri” dhe kërkesa në Këshillin gjyqësor që lëndët e parqeve kombëtare për prerje ilegale dhe veprimet e tjera ilegale të kanë prioritet në shqyrtim.
- **Evitimi i përzierjes së kompetencave menaxhuese të pylltarisë (APK-së) në parqet kombëtare.** Në bazë të Kushtetutës (neni 122. paragrafi 2) menaxhimi i parqeve kombëtare rregullohet me legjislacion të veçantë, ndërsa Ligji për Pyjet që është aprovuar në mars të këtij viti, në kundërshtim me Kushtetutën dhe Legjislacionin e parqeve kombëtare ka krijuar përzierje të kompetencave menaxhuese dhe konflikt interesi midis dy institucioneve

shtetërore: drejtorive të parqeve kombëtare dhe APK-së. Për t'u definuar çështja e kompetencave menaxhuese mbi parqet kombëtare nevojitet dërgimi i Ligjit për Pyjet në Gjykatën Kushtetuese për vlerësim, në mënyrë që të përcaktohet legjislacioni primar për zbatim në parqet kombëtare.

- **Ndalimi i ndërtimeve në PK “Sharri”, lëshimit të pëlqimeve mjedisore dhe lejeve ndërtimore deri në hartimin e Planeve rregulluese për zonat e treta të mbrojtjes;**
- **Hartimi i Planeve rregulluese detaje për zonat e treta të mbrojtjes të destinuara për zhvillimin e turizmit në territorin e PK “Sharri”;**
- **Rrenimi i objekteve ilegale në pronat publike;**
- **Hartimi i Rregullorës për rregullat, procedurat, kompetencat dhe kushtet e ndërtimeve në parqet kombëtare;**
- **Aprovimi i aktit ligjor për transformimin e paluajtshmërive (pronave dhe objekteve) shoqërore dhe publike që gjenden në PK “Sharri” në pronësi publike të Parkut Kombëtar/Qeverisë së Republikës së Kosovës;**
- **Definimi i pronësisë së parcelës dhe objekteve në Brezovicë.**

15. DAPK “Sharri” gjatë këtij viti është ballafaquar me sfida dhe probleme të ndryshme, ndër të cilët veçohen:

- Mungesa e punëtorëve (stafit profesional dhe rojtarëve të natyrës) në zyrën qendrore në Prizren dhe komunat: Dragash, Shtërpçë dhe Kaçanik. Situata është tentuar të zbutet me punësimin e 1 praktikanti/juristi dhe 11 praktikantëve/rojtareve të natyrës me kontrata të përkohshme në komunat e lartcekura nga AMMK/MMPHI.
- Përzierja e kompetencave menaxhuese të Ligjit për Pyjet ndaj parqeve kombëtare. Si pasoj tani ekzistojnë dy organizata shtetërore (Drejtoritë e parqeve kombëtare dhe APK) dhe dy legjislacione për menaxhimin e parqeve kombëtare (Ligjet për Natyrë dhe Parqet Kombëtare dhe Ligji për Pyjet) të cilët janë në kundërshtim njëra me tjetrën. Përzierja e kompetencave ka vështirësuar menaxhimin e parqeve kombëtare dhe ka krijuar pengesa në kryerjen e shërbimeve profesionale për grupet e ndryshme të interesit. Për shkak të pengesave të krijuara si pasoj e përzierjes së kompetencave të Ligjit për Pyjet në menaxhimin e parqeve kombëtare këtë vit nuk është aprovuar (nuk është dhënë leja-vendimi) nga AMMK/MMPHI Plani vjetor për mbrojtjen, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pyjeve në PK “Sharri” për vitin 2024. Në bazë të takimit të mbajtur midis AMMK-së dhe APK-së me datën 22.07.2024. janë mundësuar vetëm prerjet dhe pastrimet sanitare në pyjet private ku është prdorur dokumenacioni i APK-së: fletdamkosjet, Damkat pyjore për damkosje dhe transport, fletëpagesat dhe fletëpërcjellëset. Ky proces është përcjellur me parregullësi të shumta nga APK e cila nuk ka pasur kapacitete njerëzore dhe teknike për furnizimin e palëve me dokumentacion për transportin e druve. Mjetet financiare nga taksat në pyjet private janë derdhur në buxhetin e APK-së. Nuk janë aplikuar masat sanitare për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e pyjeve publike dhe komuniteti lokal nuk ka pasur mundësi të plotësimin të nevojave për dru zjarri për sezonën dimërore. Kjo është reflektuar në krijimin e

paknaqësive të komunitetit lokal ndaj institucioneve të shtetit, rritjen e prerjeve ilegale në gjithë territorin e PK "Sharri" dhe përkeqësimin e gjendjes së përgjithshme të pyjeve për shkak se masa e dëmtuar dhe infektuar drunore ka mbetur në pyje dhe rrezikon përhapjen e sëmundjeve bimore dhe insekteve dëmtuese.

- Buxheti dhe investimet e pamjaftueshme për të siguruar menaxhimin e qëndrueshëm të PK "Sharri". Këtë vit janë realizuar disa projekte të vogla: Brezovica, rregullimi i laurës hyrëse në Ski Qendrën Brezovica, prishja/mbyllja e rrugëve malore në malin Luboten për parandalimin e prejreve ilegale të pyjeve etj.
- Ndërtimet ilegale dhe tentimet për zhvillimin e turizmit në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së vlerave natyrore. Zonat më të rrezikuara nga ndërtimet ilegale këtë vit kanë qenë: Guri i Dellocit, Bjeshka e Grekocit, Stanët e Dubravës, Prevalla, Brezovica, Gradancë dhe Brodi (komuna Shtërpçë). Ndaj ndërtuesve ilegal janë ndërmarr masat ligjore në organet e drejtësisë;
- Prerjet ilegale të pyjeve në komunat Kaçanik (rajonet menaxhuese: Strazhë, Dubravë, Sllatinë-Jasik) dhe Shtërpçë (rajonet menaxhuese: Brod, Firajë, Berevcë dhe Vërbeshticë) ku veprojnë grupet e organizuara të vjedhësve të pyjeve.
- Mosrealizimi i fletëpadive për vepra ilegale (prerje dhe ndërtim) në Gjykatat përkatëse. Shqyrtimi fletëpadive vonohet dhe shumica hidhen poshtë ose shqyrtohen në favor të vjedhësve të pyjeve. Shkaqet kryesore për këtë gjendje janë mosfunksionimi i duhur i Prokurorisë dhe Gjykatave dhe moskoordinimi i duhur i përfaqësimit të lëndëve me Avokaturën Shtetërore në organët e drejtësisë.
- Mos definimi i pronësisë së shumicës së ngastrave të cilët janë në pronësi shoqërore të ish kooperativave bujqësore dhe ekonomive pyjore. Nevojitet që këto prona shoqërore të transferohen në pronë publike të PK Sharri.
- Kalimet dhe veprimet ilegale (prerja, gjuetia, mbledhja e bimëve, shfrytëzimi i kullosave, vjedhja e bagëtive të komunitetit lokal, etj.) nga qytetarët e Shqipërisë në zonën kufitare të PK "Sharri" nga Koritniku deri të kufiri i Kosovës me Maqedoninë e Veriut. Nevojitet që policia kufitare të jetë më e angazhuar në ndalimin e kalimeve masive ilegale të kufirit shtetëror si dhe të kontrollojë transportet e produkteve pyjore jodrunore në kufirin shtetëror;
- Mungesa e shënjestimit të kufirit të brendshëm të PK "Sharri" (zonës së parë dhe të tretë të mbrojtjes);
- Rreziku permanent për resurset natyrore nga faktorët e ndryshëm: antropogjen (njeriu), fatkeqësitë natyrore (era dhe bora), zjarret, sëmundjet bimore dhe insektet dëmtuese. Dëmet më të theksuara janë shkaktuar nga faktori njeri në formë të prerjeve ilegale të pyjeve që janë lartcekur, ndërsa dëmet në natyrë nga faktorët tjerë biotik dhe abiotik kanë qenë kryesisht sporadike (me përmasa të vogla) në gjitha terrenet e PK "Sharri".
- Mungesa e menaxhimit institucional të mbeturinave në Ski Qendrën Brezovica që ka ndikuar në grumbullimin masiv të tyre, në veçanti gjatë sezonës turistike dimërore.

5. Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtare "Bjeshkët e Nemuna".

Raporti vjetor i DAPK “Bjeshkët e Nemuna” 2024 paraqet zhvillimet dhe të arriturat kryesore të Drejtorisë si dhe progresin gjithëpërfshirës në lëmin e mbrojtjes së florës, faunes dhe natyrës në përgjithësi.

Përmes këtij raporti vjetor DAPK “Bjeshkët e Nemuna” paraqet punën dhe arritjet e saj drejtë realizimit të synimeve dhe objektivave që ia ka parashtruar vetës në planin vjetor të punës.

Gjatë periudhës kohore janar – dhjetor 2024 janë kryer një mori punësh dhe aktiviteteve të bazuara në planin vjetor.

Kryesisht fokusimi i Drejtorisë ka qenë në mbrojtjen e pyjeve, florës dhe faunës ,monitorimi, mbikëqyrja inspektive dhe ngritja e kapaciteteve profesionale, parandalimi, zvogëlimi i ndotjes së mjedisit, dhe ndalimi i ndertimeve të egra dhe degradimit të natyrës.

Gjatë kësaj periudhe kohore janë realizuar vizita të shumta në terren gjatë gjithë periudhës ku janë bërë inspektime në tërë territorit për tu njohur me gjendjen aktuale që mbreteron në territorin e parkut lidhur me prerjet ilegale dhe ndertimet eventuale që kanë ndodhur.

Gjatë vitit 2024 DAPK “Bjeshkët e Nemuna” ka realizuar aktivitete dhe detyra të përcaktuara sipas objektivave të planit të punës dhe sipas dokumenteve tjera relevante. Aktivitetet dhe veprimet kryesore kanë qenë të fokusuar kryesisht në monitorimin dhe vlerësimin e gjendjes së natyrës brenda parkut kombëtar.

Fillimisht në muajin mars - prill kemi përgatitur planin vjetor për pastrime sanitare ku kemi bazuar në të dhënat e terrenit që kanë sjellur njësitë menaxhuese nëpër komuna dhe bashkarisht me ekipin profesional të DAPK “Bjeshkët e Nemuna” kemi hartuar këtë plan dhe e kemi dërguar për miratim në AMMK, por mëqë tash është krijuar një rrethanë e re me plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të Pyjeve këtë plan nuk e kemi realizuar ne si Drejtori dhe në bazë të dhënave tona Agjencia e Pyjeve të Kosovës ka kryer punët profesionale vetëm në pyjet private ndërkaq nuk ka pasur damkim, prerje dhe transport në pyje publike. Nuk kemi asnjë të dhënë ende sa masë drusore është lëshuar nga Drejtoria Koordinuese e APK-së sepse ne kemi pasur vetëm rolin monitorues.

Edhe këtë vit kalendarik kanë vazhduar prerjet ilegale dhe tentativat për vjedhje të pyllit, por ka rënie të dukshme të prerjeve ilegale dhe kjo si rezultat i angazhimit maksimal të Drejtorisë së Parkut Kombëtar, Policisë së Kosovës, Prokurorisë, Gjykatës si dhe rritjes së vetedijësimit të qytetarëve. Gatishmeria e punëtorëve të Drejtorisë së Parkut Kombëtar ka qenë në nivel maksimal edhe pse jemi përballë me mungesa të shumta të gjerave me elementare logjistike. Gjatë kësaj periudhe kemi lëshuar 20 fletëparaqitje për vjedhje pylli ku të gjitha janë dërguar në Prokurori dhe një pjesë e tyre janë fituar nga ana e Drejtorisë dhe prerësit ilegal kanë marrë dënime të mëdha ndërkaq një pjesë tjetër është në procedurë.

Po kështu janë konfiskuar gjithsejt mbi 97.03 m³ trupa breu dhe 36.35 m³ dru zjarri dhe janë ndaluar dhe sekuestruar disa mjete si kamionë, traktorë, xhipa, kombi, sharra motorrike, sharra për ndertimin e staneve që janë zenë në kryerjen e veprës penale vjedhje pylli.

Problem dhe sfidë në vete edhe gjatë këtij viti kanë qenë ndërtimet që kanë vazhduar parreshtur sidomos në prona private por nuk janë kursyer as pronat shoqërore dhe ka qenë i pamundur ndalimi i tyre ngase qytetarët pretendojnë në të drejten zakonore të shfrytëzimit të bjeshkëve brenda Parkut Kombëtar dhe lidhur me këtë kemi lëshuar 217 procesverbale mbi kontrollin e kyer, iu kemi ndaluar punën, kemi vendosur disa shirita pas ndalimit të punës dhe kemi përgatitur dhe dorëzuar, bashkë me polici, në prokurori 217 kallëzime penale.

Përmes një komisioni profesional kemi bërë evidentimin dhe regjistrimin e ndërtimëve dhe kemi dërguar në Ministri.

Kemi kërkuar disa herë ndihmë nga Inspektoriati qendrorë dhe lokal përmes shkresave të ndryshme për parandalimin e kësaj dukurie si dhe jemi mundur ta ngrisim këtë çështje në nivel qeveritar që të bëjmë një zgjidhje adekuate, me të shpejtë dhe të qëndrueshme.

Kemi plotësuar databazën më të dhëna të sakta ku kemi intervenuar dhe ndaluar punimet si dhe kemi përgatitur listen e atyre që iu janë ndaluar punimet dhe ngritur kallëzime penale për ndërtime pa leje. Këtë listë me emra të pronarëve dhe rastet e ngritur në polici, prokurori dhe të trajtuara në Gjykata i kemi dërguar në Ministri, përkatësisht Task Forces së Gjelbërt.

Bashkë me Task Forcen kemi ndërrmarë tri aksione ku kemi bërë ndalimin e punimëve dhe sekuestrimin e disa mjetëve që kanë qene duke kryer punimet pa leje përkatëse.

Gjatë tërë këtij viti rojtarët e natyrës, tekniket dhe edhe stafi menaxherial kemi mbrojtur raste të ndryshme në Prokurori dhe Gjykata si të ndërtimëve, ndërhyrjeve në natyrë dhe prerjeve ilegale.

Meqë tani kemi edhe tre mbikëqyrës të natyrës të licencuar nga MMPH-ja një pjesë të madhe të anagzhimëve rreth ndërtimëve iu është lënë atyre dhe me angazhim dhe përkushtim të madh kanë evidentuar dhe ndaluar çdo ndërtim dhe ndërhyrje në natyrë.

Edhe gjatë këtij viti ka pasur gjueti ilegale sidomos muajve të fundit ku kemi intensifikuar veprimet dhe angazhimet në terren dhe bashkë me policinë kemi oragnizuar edhe aktivitete të përbashkëta dhe kemi përgatitur plan operativ për parandalim të tërësishem. Janë njoftuar shoqatat e gjuetarëve së qdo lloj aktiviteti i gjuetisë është i ndaluar në Parkun Kombëtar dhe në rast të aktivitetëve do të pasojnë veprime ligjore. Shoqatat kanë qenë bashkëpunuese me Drejtorinë në parandalimin e gjuetarëve ku na kanë dhënë informata të ndryshme ku me pastaj kemi intervenuar.

Kemi bërë ndalimin e disa rrugëve dhe hapjet të shtigjeve dhe rregullimi të terrëve për stane ku iu kemi rekomanduar që të pajisen me leje nga MMPH-ja dhe lidhur me këtë kemi përgatitur një shkresë komunave përkatëse që gravitojnë në Parkun Kombëtar që për qdo aktivitet të pajisen paraprakisht me pëlqime mjedisore. Kemi bërë ndalimin edhe të rrugëve ekzistuese të cilat Komunitat kanë filluar punimet e zgjerimit dhe asfaltimit të tyre pa pëlqime mjedisore edhe përkundër që tenderimi është bërë nga Qeveria dhe Komunitat dhe të gjitha kanë sjellë në Drejtori pëlqimet mjedisore.

Nga kamerat kurth që janë vendosur nga IMNK-ja në bashkëpunim me Drejtorinë e Parkut Kombëtar shihet prezenca e kafshëve të egra në të gjitha lokalitetet sidomos të dhijes së egër dhe kaprollit, ariut, ujkut, lepurit dhe në dy raste është evidentuar edhe prania e rrëqebullit, ku kemi foto dhe film të incizuar për praninë e tij. Në pjesët ku kemi identifikuar këtë kafshë kemi marrë masa rigoroze të mbrojtjes dhe kjo pjesë tashmë pothuajse është konservuar ngase ka mbrojtje

strikte. Edhe pse nuk kemi ndonjë databazë të saktë verehet haptas së numri i kafshëve të egra është rritur ku edhe në ato lokalitet që prej vitesh nuk janë parë sivjet ka pasur lëvizje të kafshëve dhe qytetarët kanë rritur interesin që ti mbrojnë dhe të bashkëpunojnë me neve si Drejtori e në raste të caktuara edhe me polici.

Kemi zhvilluar edhe aktivitete tjera të natyrave të ndryshe si pjesëmarrje në takime, grupe punuese, konferenca të ndryshme, takime më banorë vendas, takime me OJQ të ndryshme, takime më zyrtarë komunale dhe të nivelit qendror etj.

Mëqë tani kemi dy dokumente bazike dhe shumë të rendësishme Planin Hapësinor dhe Planin menaxhues të Parkut Kombëtar kemi filluar implementimin e tyre por që këto plane janë multidisiplinare dhe përfshijnë shumë akterë dhe nuk shihet i lehtë impelementimi ngase ka edhe mosdefinim të kompetencave.

Po kështu janë kryer edhe shumë punë dhe detyra konform planit vjetor si dhe angazhime tjera të cilat kanë dalë shtesë jashtë planit vjetor që kryesisht kanë të bëjnë më monitorim dhe kontroll të natyrës në përgjithësi.

Si konkluzion i këtij raporti vjetor del se angazhimi ynë si Drejtori ka qenë maksimal, kanë vazhduar efektet pozitive në të gjitha aspektet dhe detyrat e punës, është parandaluar në masë të madhe prerja ilegale, gjuetija, është rritur vetëdija e popullatës për mbrojtje të florës dhe faunës, ka nisur të krijohet një qytetari aktive në mbrojtje të këtyre vlerave natyrore, numri i prerësve ilegale është në rënie dhe po vazhdon të rritet performanca në përgjithësi e Parkut Kombëtar dhe Drejtorisë e cila menaxhon me këtë territor shumë të rendësishëm të shtetit të Kosovës.

6. Drejtoria për Menaxhimin e Monumenteve të Natyrës me Rëndësi të Veçantë

MNRV “Ujëvarat e Mirushës”

Uji ka vlerë të madhe dhe komplekse për familjet tona, ushqimin, kulturën, shëndetin, arsimin, ekonominë dhe integritetin e mjedisit tonë natyror. Uji ka një rëndësi të paçmueshme në evolucionin e botës së gjallë. Uji është praktikisht një kusht për mbijetesën e jetës në Tokë. Uji në oqeanet e botës është një rregullator natyror i temperaturës në Tokë. Uji mundëson kultivimin e kulturave bujqësore, që është kusht i domosdoshëm për prodhimin e ushqimit. Përdoret edhe në aktivitete të tjera ekonomike - ujësjellës, industri, trafik dhe aktivitete të tjera. Konsumi global i ujit po rritet çdo vit. Uji mbulon 2/3 e sipërfaqes së Tokës dhe, me një vëllim prej 1.6 miliardë kilometrash kub, përfaqëson mjedisin më të përhapur. Ujërat tokësore përbëjnë vetëm 0.5% të të gjithë trupave ujorë në Tokë dhe shpërndahen si ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Qëllimi i zhvillimit të qëndrueshëm është sigurimi i ujit për të gjithë. Uji siguron mirëqenie.

Uji do të thotë gjëra të ndryshme për njerëz të ndryshëm. Në familje, shkolla dhe vendet e punës, uji mund të nënkuptojë shëndet, higjienë, dinjitet dhe produktivitet. Në vendet kulturore, fetare dhe shpirtërore, uji mund të nënkuptojë një lidhje me krijimin, komunitetin dhe veten. Në hapësirat natyrore, uji mund të nënkuptojë paqe, harmoni dhe ruajtje.

Është e rëndësishme të theksohet se Kosova i është afruar standardeve mjedisore të BE-së dhe është bërë përparim i dukshëm në zhvillimin e legjislacionit lidhur me mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi, duke përfshirë mbrojtjen e ujit. Pajtueshmëria e legjislacionit të Kosovës me acquis të BE-së vlerësohet duke monitoruar progresin e transpozimit dhe zbatimit të legjislacionit. Në vitet e fundit, Kuvendi i Kosovës ka shqyrtuar dhe miratuar një numër të konsiderueshëm ligjesh mjedisore. Ministria ka arritur progres të dukshëm edhe në miratimin e akteve nënligjore (udhëzime administrative, dekrete, vendime, etj). Gjithashtu ka miratuar Strategjinë Shtetërore për Ujërat në Kosovë 2017-2036. Është një nga dokumentet kryesore të planifikimit të resurseve ujore në Republikën e Kosovës. Ky dokument është obligim ligjor në përputhje me synimin e Qeverisë për ta përdorur këtë dokument për të trajtuar dhe drejtuar trendet politike, operationale dhe investuese në sektorin e ujit për një periudhë 20 vjeçare e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e cila mbështetet nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, e cila monitoron gjendjen e mjedisit planifikimin dhe menaxhimin e ujërave.

Një xhevahir i veçantë i ujërave të Kosovës - Ujëvarat e Mirushës

Ujëvarat e Mirushës janë një seri ujëvarash që gjenden në parkun e Mirushës, në Kosovën qendrore. Me kalimin e kohës, ujëvarat krijuan kanione dhe shpella, të cilat janë të njohura në të gjithë rajonin. Lumi gdhendi një kanion 10 kilometra dhe krijoi 13 liqene me ujëvara mes tyre. Ujëvarat janë një nga atraksionet më të vizituara në zonë dhe njerëzit shpesh lahen atje. Muret rreth ujëvarës janë të bardha, ndërsa uji nga lumi është ngjyrë kafe e ndyrë. Shkëmbinjtë rreth disa pishinave përdoren për garat e kërcimit së larti. Shpellat e ujëvarës janë gjithashtu të njohura për vizitorët. Ujëvara më e lartë, midis liqenit të gjashtë dhe të shtatë, është 22 metra e lartë.

Në vitin 1982/83, ujëvarat e Mirushës u shpallën park rajonal të natyrës nga komuna e Klinës dhe Rahovecit, e më pas nga komuna e Malishevës. Në vitin 2012, Qeveria e Kosovës vendosi që ujëvarat e Mirushës t'i shpallë monument natyror me rëndësi të veçantë. një sipërfaqe prej 598.4 ha.

Edhe pse Kuvendi i Kosovës në vitin 2014 ka miratuar Planin Hapësinor për zonën e mbrojtur "Ujëvarat e Mirushës", qëllimi i të cilit ka qenë të ndikojë në ndalimin e kërkesave të paplanifikuara që shkaktojnë dëme në këtë zonë, dukuri negative ende ndodhin. Prandaj, do të ishte e nevojshme të rekomandohet sa vijon:

- Për të gjitha ndërhyrjet në monumentin e natyrës me rëndësi të veçantë, "Ujëvarat e Mirushës", duhet të zbatohen procedurat për mbrojtjen e natyrës në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës.
- - Inspektorati i MMPH dhe inspektorati komunal të inspektojnë subjektet ekonomike dhe aktivitetet e tyre me qëllim mbrojtjen e monumenteve të natyrës dhe ndalimin e të gjitha aktiviteteve që kanë efekt shkatërrues në vlerat e trashëgimisë natyrore.

- Krijimi i një Plani Menaxhimi të MNRV-së, "Ujëvarat e Mirushës", i cili do të përcaktonte aktivitetet e lejuara sipas shkallës së mbrojtjes,

- Marrja e masave për rehabilitimin e zones.
- Për të ruajtur vlerat natyrore të monumentit të natyrës me rëndësi të veçantë, “Ujëvarat e Mirushës” dhe kushtet në terren, duhet rekomanduar që të gjitha aktivitetet që kryhen brenda zonës së mbrojtur të jenë në përputhje me Ligjin për Natyrën. Mbrojtja Nr. 03/L-233 dhe Plani Hapësinor MNRV “Ujëvarat e Mirushës” i miratuar nga Kuvendi i Kosovës Nr. 04-V-795 nga viti 2014.

MNRV “Shpella e Gadimes”

Vlerat natyrore

Shpella e Gadimes paraqet fenomen karstik unik jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Është e zhvilluar në një thjerrëz të gëlqerorëve me moshë paleozoike të mermerizuar me dimensione të vogla hapësinore e ndërthurur në rreshtet permo-triasike. Fakti se kanalet, galeritë dhe boshllëqet e kësaj shpelle janë krijuar në mermer paleozoiku e bënë këtë shpellë të radhitet edhe me vlera ndërkombëtare.

Pasuri e shpellës janë prezencat e aragoniteve të cilat si stoli shpellorë janë dukuri të rralla. Kristalet e këtyre stolive, në shpellë paraqiten në galerinë e Aragoniteve të cilat karakterizohen me forma dhe drejtime të ndryshme të shtrirjes të cilat shpellën e bëjnë posaçërisht interesante dhe tërheqëse.

Vlerësim i Gjendjes 2024

Gjatë vitit 2024 MNRV “Shpella e Gadimes” ka punuar pothuajse çdo ditë përveç në disa festa zyrtare.

Këtë vit jemi fokusuar në mirëmbajtjen e sistemit të elektrifikimit brenda në Shpellë. Të cilat janë dëmtuar disa herë por edhe sistemi Smart për kontrollim ka rënë nga sistemi disa herë, andaj gjatë gjithë kohës ekipe të ndryshme kanë punuar që ti evitojnë problemet.

Vizitat e nxënësve të cilat organizohen nga shkollat janë një gjë shumë e zakonshme për periudhën pranverë dhe në vjeshtë, por piku me nxënës gjithnjë ka qenë në pranverë. Por këtë vit është vërejtur një numër dukshëm më i ulët i nxënësve nëpër shkolla.

Këtë vit në përgjithësi numëri i vizitorëve ka qenë më i ulët se vitin e kaluar.

Supozimet tona për numërin më të ulët të vizitorëve është liberalizimi i vizave, në këtë përfundim bijm nga numëri më i ulët i nxënësve nëpër klasë/shkolla. Pastaj tjetër indikacion është që gjatë vitit kemi hapur konkurs për praktikant disa herë dhe nuk ka pas interesim pothuajse fare për punësim pasi që ka ndalur jashtë vendit për punë.

Interesimi i mediave këtë vit ka qenë i lartë, ku që nga muaji janar e tutje kemi patur interesim storie dhe intervista të ndryshme të cilat gjithsesi kanë qenë pozitive për ngritjen e numërit të vizitorëve.

Ka patur edhe vizitorë nga Shqipëria, por kryesisht kan qenë vizita familjare, dhe nga pakë edhe organizime shkollore.

Gjithashtu kemi pasë shumë vizita nga stafi ndërkombëtarë që vepron në Kosovë, si p.sh. Trupa të KFOR-it Anglez, Amerikanë, Gjerman, Polak, Turk, Cek etj.

Këtë vit gjatë sezonës së pikut kemi pasë stafë shtesë të angazhuar qe na ka lehtesuar punen dhe vizitoret jan ndare me te knaqur.

T'ju rikujtoj qe Drejtoria e Shpellës ka vetëm dy cicerron ku një cicerrone ka shkuar ne pushim te lehonise, dhe nje cicerrone si nënë me foshnje të vogël sipas ligjit i është lejuar të punoj me orarë mën të shkurtër, mirepo tani kemi ngelur vetem me nje cicerrone e cila gjindet ne pushim te lehonise ndersa tjetra eshte transferuar per gjithnje ne MMPHI. Ndërsa shpella gjatë sezonës së verës punon më gjatëdhe ne kemi punuar nga ora 09:00 deri në ora 17:00 por kërkesa ka që të punohet deri ne ora 19:00

Gjithashtu kemi mbajtë edhe takime me komandantin e Policisë në degën e Lipjanit i cili na ka ofruar asistencë në cdo kohë, si dhe ka shpeshtuar patrullat tek shpella e vecanërishtë gjatë orëve të natës pasi që i kemi njoftuar që nuk kemi roje fizike dhe jan të njoftuar për masat e sigurisë që i kemi ndërmarr dhe ata tani janë shum vigjilent ndaj sigurisë së shpellës. Por edhe pas dy viteve të shkëputjes të kësaj kontrate për as një moment nuk na ka braktisur Policia e Republikës së Kosovës dega e Lipjanit por edhe as tëvetmn her nuk ka ndodhur që të kemi ndonjë problem.

Implikimet Buxhetore

Nga muaji Janarë deri më 01 Dhjetor 2024 nga shitja e biletave hyrëse vizitorëve të Shpellës së Gadimes jan grumbulluar 13,922.00 Euro

Ndërsa Shpellën e kan vizituar 12.867 vizitorë, ndër ta 4.649 vizitor të rritur, 2653 vizitor fëmijë nga mosha 6-16 vjecarë, 3.942 nxënës si dhe 1.623 vizitor të liruar nga pagesa (kategorit e përcaktuara me rregulloren e mbrendshme të MNRV Shpella e Gadimës)

Stafi i Shpellës

Stafi i MNRV-së përbëhet nga Udhëheqësja e sektorit të “Shpellës së Gadimës”, Zyrtarë administrativë.

Gjithashtu kemi të angazhuar tre praktikantë Stafi i MNRV-së Shpella e Gadimës punon qdo ditë të javës duke përfshir edhe fundë javët nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Ndërsa në sezonën verore sfafi punon nga ora 08:00 deri në ora 18:00

Për pastrimin e Zyrave, Shpellës mbrenda, kopshtit dhe cdo pastrim që nevoitet është e kontraktuar kompania MSS.

Raporti vjetor i aktiviteteve 2024

Adresa e AMMK-së:

Rruga Luan Haradinaj, ish-pallati i shtypit-Rilindja kati XV/04

email: ammk@rks-gov.net

www.ammk-rks.net

Prishtinë, Dhjetor 2024